

# PANDËSHKUESHMËRIA

## OPINIONI PUBLIK MBI KUPTIMIN, ARSYET DHE ROLIN E INSTITUCIONEVE

### Hulumtim Kombëtar

*Gjetjet Kryesore*



Tiranë 2015

FONDACIONI  
SHOQËRIA  
E HAPUR  
PËR SHqipërinë



**IDRA**  
RESEARCH & CONSULTING

# PANDËSHKUESHMËRIA

## OPINIONI PUBLIK MBI KUPTIMIN, ARSYET DHE ROLIN E INSTITUCIONEVE

**Hulumtim Kombëtar**

*Gjetjet Kryesore*



**Ekipi i Autorëve - IDRA**

Auron Pasha  
Enfrid Islami  
Ivi Rexhepi

**Ekipi i Koordinatorëve të Sondazhit**

Esjona Kryemadhi  
Fatjola Gora  
Ela Koci  
Fjorinda Lazi

**Ekipi i Analistëve të të dhënave**

Pjerina Dodbiba  
Fajket Agalliu

**Viti i Publikimit** - 2015

© Instituti Për Kërkime Dhe Alternativa Zhvillimi - IDRA

---

**Instituti Për Kërkime Dhe Alternativa Zhvillimi - IDRA**

IDRA është një institut jo fitim prurës, jo qeveritar i krijuar nga një grup studjuesish me eksperiencë në vitin 2000. IDRA promovon vlerat e lirisë dhe demokracisë, ekonomisë së tregut të lirë, dhe shoqërisë civile, dhe është vazhdimisht në shërbim të demokratizimit të shoqërisë shqiptare dhe procesit të integritimit në Bashkimin European.

Misioni i IDRA-s është që të shërbejë si një institut që siguron ekspertizë si dhe një urë efektive ndërmjet komunitetit dhe institucioneve, duke qënë i vëmëndshëm ndaj problemeve me të cilat ballafaqohet shoqëria shqiptare dhe duke rritur bashkëpunimin dhe dialogun jopartiak, etik, dhe profesional.

**SHËNIM**

Ky studim është përgatitur nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA) me mbështetjen e Fondacionit të Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë, Soros. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e Fondacionit Soros.

## Përmbajtja

<b>1. Përmbledhje Ekzekutive.....</b>	<b>4</b>
2.1 Objektivat e Studimit.....	9
2.2 Konteksti i Hulumtimit.....	9
2.3 Metodologjia e Hulumtimit.....	14
<i>Sondazhi Sasior.....</i>	<i>15</i>
<i>Komponenti Cilësor.....</i>	<i>16</i>
<i>Intervistat në Thellësi.....</i>	<i>16</i>
<i>Marzhi i Gabimit.....</i>	<i>16</i>
<b>3. Gjetjet kryesore – Kampioni i popullatës së përgjithshme.....</b>	<b>18</b>
3.2 Informacioni i Përgjithshëm.....	18
3.3 Burimet e informacionit dhe Aktivizimi qytetar.....	22
3.4 Pandëshkueshmëria.....	27
3.5 Indeksi i Pandëshkueshmërisë.....	36
3.6 Besimi në institucione dhe Vlerësimi i Performancës.....	37
3.6.1 Gjqësori.....	41
3.6.2 Policia e Shtetit.....	45
3.6.3 Prokuroria e Përgjithshme.....	48
<b>4. Gjetjet Kryesore - Kampioni i të Rinjve.....</b>	<b>53</b>
4.1 Informacion i Përgjithshëm.....	53
4.2 Vlerësimi i Performancës së Institucioneve ( Të Rinj ).....	56
4.2.1 Gjqësori.....	56
4.2.2 Policia e Shtetit.....	59
4.2.3 Prokuroria e Përgjithshme.....	61

## Përmbledhje Ekzekutive

- **Pavarësisht se sa aktivë dhe të përfshirë janë, qytetarët shqiptarë shprehen përgjithësisht të interesuar për zhvillimet e ndryshme sociale, politike apo ekonomike në vend.** Të pyetur se sa të interesuar janë për zhvillimet e ndryshme sociale, apo ekonomike në vend, 67% e të intervistuarve shprehen “deri diku të interesuar” (35%) ose “shumë të interesuar” (32%). Ky interes është pothuajse i njëjtë midis meshkujve dhe femrave, me një tendencë pak më të lartë tek meshkujt (67% vs. 62%). Interesi për këto çështje ndërmjet të rinjve 18-24 vjec është disi më i vogël se ai ndërmjet të rriturve mbi 24 vjec (59% vs. 65%).

**Ekonomia është kryefjala e problemeve me të cilat përballlet Shqipëria sipas qytetarëve. Në shkallën e rëndësisë, kur u duhet të zgjedhin, Ekonomia, Papunësia dhe Varfëria eklipsojnë problemet e tjera në mendjet e qytetarëve.** Ekonomia shihet si problemi kryesor me të cilin përballlet vendi, nga 37% e të intervistuarve, e ndjekur nga papunësia, përmëndur gjithashtu nga 34% e qytetarëve. Megjithatë kur u duhet ti vlerësojnë më vete si sfida, Korrupsioni dhe Pandëshkueshmëria shihen si sfidat më të mëdha të vendit nga 85% dhe 74% e të anketuarve respektivisht.

- **Televizioni, bisedat me miqtë dhe familjen, si dhe gazetat janë burimet kryesore të informimit mbi zhvillimet në vend për qytetarët Shqiptarë.** Kështu, 98% e të intervistuarve përzgjedhin televizionin si burimin kryesor për informim, të ndjekur nga 44% të cilët zgjedhin bisedat me miqtë, si dhe 30% të cilët përzgjedhin gazetatat. Ndërkohë, interneti, shihet si burim kryesor i informacionit nga vetëm 1 në 5 të intervistuar.
- **Qytetarët Shqiptarë konsiderojnë Median si institucionin më të rëndësishëm në investigimin e rasteve të abuzimit me ligjin nga zyrtarët e lartë në vend.** Rreth 2 në 3 të intervistuar mendojnë se Media po bën punën më të mirë në Shqipëri përse i përket investigimit dhe raportimit të rasteve të abuzimit me pushtetin nga zyrtarët e lartë në vend.
- **Media në Shqipëri - edhe “heroike” edhe “e tulatur”.** Media, konsiderohet gjerësisht nga qytetarët shqiptarë si aktori më i suksesshëm në investigimin dhe raportimin e shkeljeve të ligjit nga zyrtarët e lartë publik duke lënë pas institucionet që e kanë detyrë funksionale këtë gjë. Rreth 86% e të anketuarve e konsiderojnë median si aktor të suksesshëm në këtë drejtim krahasur me 42% që konsiderojnë Policinë dhe vetëm 17% që konsiderojnë Prokurorinë. E megjithatë, janë rreth 62% e të anketuarve që thonë se Media është e kufizuar nga interesi Ekonomike-Politike, ose që mediat kritike me qeverinë ndodhen në presion të vazhdueshëm ekonomik dhe politik (64%).

- ***Pavarësisht se Korrupsioni, Shkelja e Ligjit dhe Pandëshkueshmëria shihen si probleme të mëdha, shumë pak qytetarë deklarojnë se janë përfshirë në aktivitete që denoncojnë veprimtari të tilla.***

Rreth 7 persona ndër 10 të pyetur, deklarojnë se Pandëshkueshmëria është një fenomen shumë i përhapur në Shqipëri. Pjesa tjetër deklarojnë se është një fenomen “deri diku i përhapur”. Pavarësisht kësaj mase të madhe, vetëm 10% e të anketuarve deklarojnë se kanë marrë pjesë në ndonjë protestë apo marshim për të denoncuar fenomene të tilla. Me të paktë janë ata që kanë takuar ndonjë zyrtar për këtë arsye, që kanë nënshkruar ndonjë petition apo që kanë denoncuar në rrjete sociale.

- ***Gatishmëria për të raportuar shkelje ligjore me sfond korruptiv nuk është shumë e madhe midis qytetarëve.*** Vetëm 36% e të anketuarve deklarojnë se janë “shumë të gatshëm” të raportojnë manipulime me një tender në punën e tyre. Vetëm 40% do të raportonin falsifikim dokumentash nga eprori i tyre dhe vetëm 39% do të raportonin një koleg që ka pranuar një rryshfet duke favorizuar një kompani/person tjetër. Megjithëse skenaret janë hipotetike dhe personat e pyetur mund të shprehen lirisht, këto shifra tregojnë për një ngurrim në një pjesë të madhe të qytetarëve për të denoncuar e raportuar fenomene korruptive. Për kontrast, rreth 60% e atyre, deklarojnë se do të raportonin “vjedhjen me dhunë të një personi”, një skenar që paraqet veprimtari kriminale por jo me sfond korruptiv.

## **PANDËSHKUESHMËRIA**

- ***Pandëshkueshmëria shihet nga shumica e qytetarëve si një fenomen që është mjaft i përhapur në Shqipëri.*** Pothuajse 7 në 10 të intervistuar mendojnë se Pandëshkueshmëria është një fenomen mjaft i përhapur në Shqipëri. Gjetjet e dimensionit cilësor, tregojnë se qytetarët e konsiderojnë pandëshkueshmërinë si një fenomen shumë problematik, sidomos përsa i përket shkeljeve nga zyrtarët e lartë publik.
- ***Korrupsioni, moszbatimi i ligjeve si dhe mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë, shihen nga respektivisht 78%, 74% dhe 72% të intervistuarve si faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend.*** Studimi cilësor, nxjerr në pah gjithashtu faktin se mungesa e shëmbujve konkret të ndëshkimit të zyrtarëve të lartë gjatë viteve, ka nxitur një perceptim të tillë të qytetarëve për pandëshkueshmërinë.
- ***Ekziston një kontrast i thellë midis asaj çfarë mendojnë qytetarët përsa i përket mundësisë që ata vetë të ndëshkohen për shkelje ligjore dhe asaj që***

*ata mendojnë se ndodh me një zyrtar të lartë për të njëjtat shkelje. Ligji sipas tyre ndryshe vepron për ata (si qytetarë të thjeshtë) dhe ndryshe për një person të veshur me pushtet.* Të vendosur përpara disa skenarëve hipotetike për shkelje të ndryshme ligjore, të anketuarit kanë dhënë përgjigje se sa mundësi ka që ata të kapen dhe të ndëshkohen për to<sup>1</sup>. Indeksi i Pandëshkueshmërisë Personale shënon 62 pikë në shkallën nga 0 deri në 100, kurse Indeksi i Pandëshkueshmërisë së Zyrtarëve të lartë shënon vetëm 25 pikë në po të njëjtën shkallë dhe për të njëjtat shkelje.

- *Perceptimi që qytetarët kanë, qartësisht tregon se sipas tyre mundësitë që një zyrtar të kapet dhe të dënohet për shkelje të ligjit janë shumë të pakta.* Edhe pjesëmarrësit në fokus grupe mendojnë se zyrtarët e lartë ushtrojnë influencën e tyre mbi institucionet ligjzbatuese, në mënyrë që hetimet ndaj tyre ose të mos nisin fare, ose që të mos çojnë asnjëherë në një përfundim konkret. Është interesante të vihet re se skenaret ku transaksioni korruptiv është më i dukshëm (“Paguani dikë nën dorë në një institucion për të marrë një shërbim” dhe “Ndërhyni për të punësuar një të afërm/të njohur jashtë procedurave”) janë edhe ato që kanë shënuar më pak pikë në shkallën e mundësisë për tu ndëshkuar.

## **BESIMI NË INSTITUCIONE & VLERËSIMI I PERFORMANCËS**

- *Të pyetur mbi besimin që kanë tek institucionet e ndryshme, rezultatet tregojnë një besim relativisht të ulët qytetarëve tek institucionet e ndryshme shtetërore, si dhe tek aktorë të ndryshëm të shoqërisë. Policia, (53 pikë nga 100), Kryeministri ( 51 nga 100) dhe Drejtuesit Fetarë (46 nga 100), janë momentalisht institucionet ku qytetarët Shqiptarë kanë më tepër besim. Ndërkohë, ILDKP Prefekti, dhe Gjyqësori janë institucionet ku qytetarët kanë më pak besim, me respektivisht 29, 28, dhe 26 pikë nga 100 të mundshme.*
- *Sistemi Gjyqësor shihet prej shumicës së qytetarëve si i korruptuar, dhe nën influencën politike. Rreth 34% e të intervistuarve e vlerësojnë punën e Gjyqësorit “shumë keq” (17%) ose “keq” (17%), ndërsa vetëm 2% e të intervistuarve e kanë vlerësuar punën e Gjyqësorit si “shumë mirë” dhe 25% si “të mirë” Qytetarët momentalisht mendojnë se sistemi Gjyqësor po bën punë të keqe në luftën ndaj pandëshkueshmërisë.*
- *Ryshfeti, lidhjet e biznesit të gjykatësve, si dhe politika, shihen si faktorët kryesorë e që ndikojnë në dhënien e verdikteve nga gjykatat në Shqipëri, ndërkohë që faktet dhe ligjet e aplikueshmë për çdo rast, konsiderohen si faktori që ndikon më pak në këtë aspekt. Rreth 84% e të intervistuarve mendojnë se “Ryshfeti”*

1 Shkalla është konvertuar nga 0 në 100 ku 0= Aspak mundësi dhe 100= Ka shumë mundësi.

është një faktor që “influencon shumë” vendimet e gjyqtarëve, ndërsa vetëm 40% mendojnë se “faktet dhe ligji i aplikueshëm” influencon “shumë” në dhënien e vendimeve nga gjyqësori.

- **Përgjithësisht, puna e Policisë së Shtetit vlerësohet si pozitive nga qytetarët** kryesisht për shkak të shtimit të trupave në terren si dhe iniciativat e fundit. Rreth 7 në 10 të intervistuar mendojnë se puna e Policisë së Shtetit aktualisht është “shumë e mirë” (17%), ose “e mirë” (53%).
- **Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve Shqiptarë nuk kanë informacion të mjaftueshëm** mbi punën e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe prokurorët në përgjithësi. Rreth 34% e të intervistuarve ka dhënë një vlerësim neutral për punën e Prokurorisë së Përgjithshme, ndërsa pothuajse i njëjti numër të intervistuarish e ka vlerësuar punën e Prokurorisë si “shumë të mirë” ose “të mirë.” Shumica e qytetarëve (86%) mendon se Prokuroria e Përgjithshme nuk e zbaton ligjin njësoj për të gjithë qytetarët.
- **Në përgjithësi, prokurorët në Shqipëri shihen nga qytetarët si nën influencën e vazhdueshme politike dhe ekonomike.** Rreth 85% e qytetarëve mendojnë se influencat politike dhe ekonomike i pengojnë prokurorët që të veprojnë me profesionalizëm gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **TË RINJTË: PËRVOJA DHE PERCEPTIME**

- **Të rinjtë në Shqipëri, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, shohin** korrupsionin, mungesën e ligjeve dhe cilësisë së tyre dhe mosfunksionimin e sistemit të drejtësisë si faktorët kryesorë në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend. Rezultatet tregojnë se 4 në 5 të rinj të intervistuar mendojnë se *Korrupsioni, dhe Mungesa e Ligjeve*, janë faktorë shumë të rëndësishëm përse i përket ndikimit në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend.
- **Perceptimi i të rinjve mbipërhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë** në vend, ndryshon pak ose aspak nga ai i pjesës tjetër të popullsisë. Të rinjtë gjithashtu mendojnë se ka pak gjasa që të ndëshkohen për shkeljet e rënda, ndërsa më shumë mundësi për shkeljet e lehta ligjore. Të rinjtë Shqiptarë mendojnë se ka më shumë mundësi të ndëshkohen nëse falsifikojnë dokumentat (74 pikë nga 100 të mundshme), apo nëse u shmangen taksave me 70 nga 100 pikë të mundshme.
- **Vlerësimi i të rinjve mbi performancën e sistemit gjyqësor është relativisht më pozitiv krahasuar** me pjesën tjetër të popullatës. Rreth 20% më tepër të rinj të grupmoshës 18-24 vjeç, e vlerësojnë punën e sistemit Gjyqësor në Shqipëri si “shumë të mirë” ose të “mirë”. Megjithatë, edhe nga të rinjtë, sistemi gjyqësor shihet si nën influencën e politikës dhe i prekur nga fenomeni i korrupsionit.



- **Më shumë se gjysma e të rinjve të intervistuar, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, besojnë se Gjykatat në Shqipëri,** ndodhen nën presionin e vazhdueshëm të politikës. Ndërsa 1 në 2 të intervistuar mendojnë se gjyqtarët në Shqipëri nuk kanë kualifikimin e duhur për të ushtruar detyrën e tyre, duke dhënë kështu shpesh vendime të gabuara.
- **Të rinjtë në Shqipëri, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, mendojnë se faktet dhe ligjet ndikojnë relativisht pak në vendimet e dhëna nga gjykatat në Shqipëri.** Vetëm 1 në 3 të rinj të intervistuar mendojnë se faktet janë të rëndësishme në dhënien e vendimeve gjyqësore në vend. Shumica dërrmuese e të rinjve të intervistuar, (4 në 5) mendojnë se Paraja/Ryshfeti influencën shumë në vendimet e gjykatave në Shqipëri.
- **Shumica e të rinjve në vend, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, e vlerëson me nota pozitive performancën e Policisë së Shtetit.** Më shumë se 4 në 5 të rinj të intervistuar e vlerësojnë pozitivisht punën e Policisë së Shtetit ("mirë" ose "shumë mirë").
- **Megjithatë, shumë prej të intervistuarve, në mënyrë të ngjashme me pjesën tjetër të popullatës, mendojnë se Policia e Shtetit është ende nën presion të vazhdueshëm politik.** Pothuajse 3 në 5 të intervistuar nga grupmoshat e reja (18-24 vjeç) mendojnë se presioni politik mbi Policinë e Shtetit ka cënuar performancën e saj dhe rrjedhimisht besimin e publikut tek ky institucion.
- **Krahasuar me popullatën e gjerë,** të rinjtë Shqiptarë e vlerësojnë më pozitivisht punën e Prokurorisë së Përgjithshme. Pothuajse gjysma e të rinjve (18-24 vjeç) të intervistuar mendojnë se Prokuroria e Përgjithshme ka bërë punë "të mirë" (42%), krahasuar me 28% të pjesës tjetër të popullatës që ndan të njëjtin mendim.
- **Megjithatë, shumë prej të rinjve të intervistuar shprehën skeptikë** përsa i përket aftësisë së prokurorëve në Shqipëri për tu rezistuar influencave politike dhe fenomenit të korrupsionit. Rreth 4 në 5 të rinj të intervistuar "nuk janë aspak dakord" ose "nuk janë dakord" me pohimin sipas të cilit prokurorët në Shqipëri janë të pavarur nga influencat politike gjatë zbatimit të ligjit.
- **Në mënyrë të ngjashme me pjesën tjetër të popullsisë, Media, Qeveria dhe Policia,** shihen nga të rinjtë si institucionet të cilët po bëjnë punën më të mirë në luftën kundër pandëshkueshmërisë me respektivisht 28%, 15% dhe 13% të intervistuarve të cilët ndajnë këtë opinion.
- **Parlamenti, KLSH (Kontrolli i Lartë i Shtetit), si dhe ILDKP (Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë),** janë institucionet që po bëjnë më pak për luftën kundër fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend, sipas të rinjve.

## 2.1 Objektivat e Studimit

Studimi mbi *“Pandëshkueshmërinë - Perceptime dhe Eksperienca të Qytetarëve Shqiptarë”*, i financuar nga Fondacioni Soros në Shqipëri, është pjesë e një përpjekje të përbashkët e IDRA, si dhe me partnerëve të tjerë nga shoqëria civile. Ky projekt synon të ndërtoj një tablo të gjerë të perceptimeve dhe përvojave të shoqërisë shqiptare mbi fenomenin e pandëshkueshmërisë, kriminalitetit, si dhe rolit të medias në luftën ndaj tyre.

Më specifikisht, studimi i IDRA-s mbi *“Pandëshkueshmërinë”*, synon kryesisht matjen perceptimit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri, kuptimin e këtij fenomeni nga publiku, rolin e institucioneve të ndryshme në përhapjen e luftës ndaj tij si dhe faktorëve (kulturor, social, ekonomik) të cilët influencojnë ekzistencën e tij. Ky studim prezanton një set indikatorësh të matshëm të fenomenit të pandëshkueshmërisë përmes një sondazhi kombëtar përfaqësues. Indikatorit i *“pandëshkueshmërisë”* që paraqitet më poshtë mund të shërbejë si një mekanizëm gjurmues mbi përhapjen e fenomenit në vitete ardhshme.

Gjithashtu, ky studim prezanton një set tjetër indikatorësh të cilët kanë si qëllim të masin besimin e qytetarëve Shqiptarë tek institucionet e ndryshme, dhënien e një vlerësim të performancës së këtyre institucioneve në kohë, si dhe perceptimin e përhapjes së korrupsionit si një faktor të rëndësishëm në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri.

Përmes një kombinimi të metodave cilësore të hulumtimit (Fokus Grupe dhe Intervistat në Thellësi) ky studim paraqet një panoramë të plotë të faktorëve të cilët ndikojnë në përhapjen e pandëshkueshmërisë, ndërsa sugjeron gjithashtu një metodologji të unifikuar mbi matjen e fenomenit në të ardhmen.

## 2.2 Konteksti i Hulumtimit

Në 24 Qershor 2014, Këshilli i Ministrave të Jashtëm të Bashkimit European miratoi dhënien e statusit kandidat për Shqipërinë, duke votuar pro propozimit të Komisionit European në Tetor të 2013. Aplikimi i Shqipërisë për anëtarësim ishte refuzuar në tre raste të mëparshme, dhe më specifikisht në 2010, 2011, dhe 2012. Raporti i Komisionit European i publikuar në Tetor 2013, theksonte se Shqipëria ka bërë përmirësime të konsiderueshme përsa i përket Bashkëpunimit Rajonal dhe Marrëdhëniet e Fqinjësisë së mirë, stabilitetit makroekonomik, funksionimin e parlamentit dhe transparencën e procesit legjislativ, reformat integruese për në BE, reformën e administratës publike, si dhe në luftën kundër krimit të organizuar.

---

2 Progres Raporti i Komisionit European për Shqipërinë, 8 Tetor, 2014, Bruksel

Pavarësisht përmirësimeve të konsiderueshme të listuara në raportin e 2014, Komisioni nënvizon edhe disa mangësi në përmbushjen e kritereve të paracaktuara nga BE. Një nga fushat në të cilat vihej re mungesa e rezultateve konkrete, ishte nevoja për ndërtimin e një historiku të ndëshkimeve, sidomos për zyrtarët e lartë në Shqipëri. Mungesa e një historiku të tillë në Shqipëri, është vënë në pah në mënyrë të vazhdueshme nga raportet e komisionit Europian gjatë viteve të fundit.

Këto raporte, vërejnë se përhapja e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend është kthyer në një sfidë të përhershme në rrugën e integritit Europian, sidomos që nga momenti kur Shqipëria aplikoi zyrtarisht për anëtarësim në 2009, gjatë presidencës Çeke. Për më tepër, bazuar në raportimet e Komisionit Europian, fenomeni duket se është mjaft i përhapur edhe në disa prej vendeve të tjera të rajonit (Shiko raportet e Komisionit Europian 2013 për Malin e Zi, Maqedoninë.) Përjashtim ndoshta bën Kroacia, historiku i së cilës përsa i përket ndëshkimeve të zyrtarëve të lartë aktualisht konsiderohet si model i suksesshëm nga Bashkimi Europian.

Termi “Pandëshkueshmëri” përgjithësisht i referohet pamundësisë për të dënuar shkelësit e ligjit (individë ose grupe) me influencë politike, kriminale, apo ekonomike, të cilët përfshihen në aktivitete të jashtëligjshme, shpesh duke abuzuar me pozicionet e tyre publike. Situata e paqëndrueshme politike, korrupsioni, si dhe një sistem gjyqësor tejet i kritikuar, sipas raporteve ndërkombëtare, vazhdojnë të jenë disa nga faktorët kryesor të cilët e kanë bërë raportimin dhe dënimin e zyrtarëve publik abuzues në Shqipëri shumë të vështirë, në mos të pamundur.

Fenomeni i pandëshkueshmërisë në Shqipëri (por edhe më gjërë) shfaqet në forma të ndryshme, të cilat në thelb lidhen me faktin që jo të gjithë qytetarët trajtohen si të barabartë përballë ligjit. Forma më e zakonshme e shfaqjes së fenomenit të pandëshkueshmërisë lidhet me rastet e korrupsionit në të cilët përfshihen individët me lidhje të fuqishme politike apo kriminale, dhe që si rrjedhojë kanë influencë të konsiderueshme mbi agjensitë ligjzbatuese. Në shumicën e rasteve, ky grup individësh arrijnë ti shmangen përballjes me ligjin për shkak të lidhjeve dhe influencave të tyre.

Në 20 vitet e fundit, përhapja e fenomenit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri është nënvizuar si shqetësim nga raportet kombëtare dhe nga ato ndërkombëtare (veçanërisht Komisioni Europian). Këto dokumenta, në mënyrë konstante, kanë raportuar mungesën e vullnetit të qeverisë Shqiptare për të adoptuar reforma legjislative të nevojshme për të përballuar sfidën e pandëshkueshmërisë në Shqipëri. Korrupsioni, mangësitë e kornizës legjislative (kodi penal dhe kushtetuta), një lloj apatie qytetare përsa i përket raportimi të çështjeve të abuzimit me pushtetin, si dhe vendime gjyqësore të konsideruara

gjerësisht si të padrejta, duket se janë disa nga arsyet që kanë çuar në përhapjen e këtij fenomeni në vend.

Sipas raporteve të sipërpërmendura, aftësia e sistemit gjyqësor në Shqipëri për të dhënë vendime të paanshme çënohet seriozisht nga fakti që shumica e emërimeve të gjyqtarëve janë nën influencën e parlamentit ose të presidentit. Sipas një sondazhi të 2010 mbi <sup>3</sup>*Integritetin dhe Rezistencën ndaj Korrupsionit të Organeve Ligjzbatuese në Vendet e Europës Juglindore*, 33% e prokurorëve, oficerëve të policisë dhe gjykatësve të intervistuar në Shqipëri, mendojnë se anëtarët e Parlamentit, janë grupi i cili ka më shumë gjasa të *“ushtrojë presion direkt ose indirekt mbi sistemin gjyqësor”*. Sipas të njëjtit raport, 67% e prokurorëve në vend deklarojnë se janë përballur personalisht me raste kur janë bërë përpjekje për të *“influencuar vendimet në rastet e korrupsionit në nivele të larta.”*

Pavarësisht se disa prej raporteve të fundit (2012, 2013) kanë vënë në pah disa përpjekje në këtë aspekt, po këto raporte theksojnë gjithashtu se mbetet ende shumë për tu bërë për të rritur numrin e zyrtarëve publik dhe politikanëve të dënuar për abuzim me pushtetin dhe korrupsion.

Më specifikisht, në 2012, <sup>4</sup>Raporti i Kreut të Prezencës së OSBE në Shqipëri theksonte se *“Përpjekjet për të hetuar zyrtarët e lartë vijnë të jenë modeste (krahasuar me zyrtarët e nivelit të ulët)”,* ndërsa nënvizonte gjithashtu se disa institucione si ILDKP-ja, kritikonin *“mungesën e ndjekjes nga Zyra e Prokurorisë të rasteve të dosjeve të dorëzuara mbi zyrtarët e lartë të dyshuar për korrupsion.”* Sipas të njëjtit raport të <sup>5</sup>2012, *“perceptimi publik -*

*përfshirë dhe atë të investitorëve të huaj të mundshëm- mbi pavarësinë dhe paanësinë e gjykatave, mbetet i ulët.”* Për më tepër, raporti nënvizon faktin se korrupsioni në nivelet e ulëta *“ndonjëherë zbulohet dhe dënohet”*. Ndërkohë, në nivelet e larta, *“korrupsioni rrallë hetohet”* me zyrtarë të lartë publik dhe biznesmen që gëzojnë *“pothuaj imunitet të plotë”*.

Në 2011, raporti mbi *“Praktikat e të Drejtave të Njërit në Shqipëri”* nga Departamenti Amerikan i Shtetit, theksonte se *“qeveria jo gjithmonë i ndërmerre të gjitha hapat për të dënuar zyrtarët”* ndërsa theksonte gjithashtu se *“Shumë zyrtarë të qeverisë gëzojnë imunitet nga hetimet”*.

---

3 Raporti për Integritetin dhe Rezistencën ndaj Korrupsionit të Organeve Ligjzbatuese në Evropën Juglindore”, 2010, Transparency International Romania

4 Raporti I Kreut të Zyrës Përfaqësuese së OSBE në Tiranë, 20 Shtator, 2012

5 “Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja”, Tiranë, 2010, IDRA

Mungesa e një historiku të suksesshëm të dënimit të zyrtarëve të lartë publik, padyshim që ndikon edhe në besimin e publikut mbi institucionet ligjzbatuese, dhe në rastin e Shqipërisë, veçanërisht mbi sistemin gjyqësor në vend. Në 2010<sup>6</sup>, një sondazh i IDRA mbi “Korrupsionin në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja”, nxirrte në pah se Policia e Shtetit, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Gjykata e Lartë, ishin disa prej institucioneve tek të cilat besimi i publikut ishte shumë i ulët. Në një shkallë nga 0 (Nuk kam aspak besim) tek 100 (Kam shumë besim), rezultatet e këtij sondazhi tregonin se Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme ishin në kuotën e 49 pikëve. Gjithashtu, sipas të njëjtit raport, 64% e të intervistuarve kishin “pak” ose “aspak” besim tek sistemi gjyqësor.

Si pjesë e përpjekjeve për reformimin e sistemit të drejtësisë, rritjes së transparencës së këtij sistemi, si dhe të besimit të publikut tek ai, në 2011, qeveria shqiptare miratoi “Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë”. Strategjia u hartua në bashkëpunim me ekspertët e Bashkimit Europian, si dhe partnerë të tjerë ndërkombëtare duke pasur si qëllim kryesor luftën ndaj fenomenit të pandëshkueshmërisë. Bazuar në këtë strategji, përafrimi i kornizës ligjore dhe administrative të sistemit të drejtësisë me *acquis communautaire*, do të garantonte “zbatimin efektiv të legjislacionit ekzistues” dhe gjithashtu do të shëndrronte “proçedurat gjyqësore në eficiente dhe të shpejta” duke evituar kështu vonesat e pajustificuara në gjykim. Strategjia gjithashtu synonte të ishin pjesë e përpjekjeve të organeve ligjvënëse dhe ekzekutive për të dekurajuar fenomenin e korrupsionit në vend, veçanërisht tek zyrtarët publik.

Ndërkohë, në 2014, Shqipëria renditej e 38 nga 129 vende të monitoruara për transformimin e tyre Politik dhe Ekonomik nga <sup>8</sup>Indeksi i Transformimit të Bertel Stiftung. Shqipëria humbi 9 pozicione (43 nga 129) në renditjen specifike të bërë për Indeksin e Transformimit Politik krahasuar me 2012 (34 nga 128). Një nga komponentët që raporti përdor për të analizuar transformimin Politik të vendeve është Sundimi i Ligjit, i cili në vetvete përfshin abuzimin e zyrtarëve publik.

Sipas këtij raporti, megjithëse ka pasur “disa zhvillime” në hetimin e zyrtarëve të nivelit të ulët, politikat e anti-korrupsionit cilësohen si “përgjithësisht retorike, veçanërisht përsa i përkët hetimit të zyrtarëve të lartë publik.” Raporti gjithashtu thekson faktin se shumica e rasteve të abuzimeve me pushtetin nga zyrtarët e lartë publik të raportuara nga media, nuk arrijnë të dalin përballë gjykatës.

6 “Korrupsioni në Shqipëri: Perceptime dhe Përvoja”, Tiranë, 2010, IDRA

7 Strategjia Ndërsektoriale Anti Korrupsion 2014-2020, Dhjetor 2013, Tiranë

8 Bertelsmann Stiftung, BTI 2014 – Albania Country Report. Gütersloh: Bertelsmann Stiftung, 2014

Si pjesë e procesit të integritetit European, në vitet e fundit Shqipëria ka prezantuar një numër të konsiderueshëm ndryshimesh ligjore/legjislative. Këto amendime, kanë patur si synim amendimin e kornizës ligjore e cila shpesh e ka bërë të vështirë ndjekjen penale për zyrtarët e lartë publik në vend. Raportet e fundit të Komisionit European (2012, 2013) i kanë vlerësuar këto ndryshime pozitivisht.

Megjithatë, po këto raporte theksojnë gjithashtu se mbetet ende shumë për tu bërë për të rritur numrin e zyrtarëve publik dhe politikanëve të dënuar për abuzime dhe shkelje ligjore. Për të bërë të mundur një përmirësim të tillë, këto raporte kanë vënë theksin tek nevoja për një reformë të thellë të sistemit gjyqësor në vend si dhe për paraqitjen e mekanizmave më efektive të anti-korrupsionit në Shqipëri. Deri më sot, reformat që kanë patur si synim garantimin dhe forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, janë fokusuar më së shumti tek procedurat e emërimit të gjyqtarëve në nivelet e ndryshme të sistemit. Vitet e fundit në Shqipëri janë ndërmarrë mjaft nisma, kryesisht në formën e ndërhyrjeve në legjislacion, për të rritur eficiencën e mekanizmave dhe institucioneve të përfshira në luftën anti korrupsion. Në vitin 2012, Ministria e Drejtësisë po ashtu nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Memorandumi kishte si synim shmangien e mbivendosjes së kompetencave të këtyre institucioneve në inspektimin e sistemit Gjyqësor. Memorandumi gjithashtu synonte rritjen e kontrollit mbi proceset gjyqësore për të garantuar paanshmërinë e gjyqtarëve, si dhe respektimin dhe zbatimin efektiv të ligjit në dhënien e vendimeve. Koordinimi më i mirë midis këtyre dy institucioneve mendohet të sjellë efekte pozitive për shkurtimin e kohës si dhe rritjen e cilësisë së inspektimit të gjyqtarëve në vend.

Në 2013, edhe Kodi penal i Republikës së Shqipërisë pësoi disa ndryshime në këtë aspekt. Bazuar në këto ndryshime, rastet e korrupsionit të zyrtarëve publik tashmë do të gjykoheshin nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Kjo Gjykatë do të ishte në të njëjtën kohë përgjegjëse për autorizimin e procedurës së arrestit, kontrollit personal apo të pronës së anëtarëve të parlamentit, gjykatësve të Gjykatave Kushtetuese, si dhe të Gjykatës së Lartë. Për më tepër, në 2013 qeveria Shqiptare paraqiti disa ndryshime në ligjin mbi *“Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së lartë në Republikën e Shqipërisë”*, me qëllim vendosjen e kritereve më të forta për përzgjedhjen e gjyqtarëve në këtë gjykatë. Ndryshimet e paraqitura për procedurat e emërimeve gjithashtu synonin rritjen e transparencës të këtij procesi për publikun. Amendamentet synonin, në të njëjtën kohë të garantonin një proces gjithëpërfshirës, duke eliminuar kështu risqet e influencave politike të njëjës palë mbi një degë tejet të rëndësishme të gjyqësorit në vend.

---

9 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8588, Datë, 15.03.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, Nëntor, 2014

Pavarësisht faktit se ndryshimet e sipërmëndura në legjisllacion kanë pasur si synim kryesor përmirësimin e mekanizmave dhe instrumenteve në luftën kundër Pandëshkueshmërisë në Shqipëri, efekti i tyre në terren është ende pak i dukshëm. Studime të ndryshme gjatë viteve të fundit tregojnë për një nivel të ulët besimi të qytetarëve tek institucionet kryesore në luftën ndaj fenomenit. Vijon të ekzistojë një perceptim sipas të cilit mundësitë që një zyrtar i lartë në Shqipëri të ndëshkohet për abuzime me ligjin, janë shumë të pakta, në rastin më të mirë. Ky studim, përveç se paraqet një pasqyrë të opinionit publik përsa i përket përhapjes së fenomenit në Shqipëri, ofron një analizë të detajuar të arsyeve pse ky fenomen ekziston. Raporti gjithashtu përmban rekomandime nga aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile të cilat mund të shërbejnë si mbështetje për institucionet vendimmarrëse në të ardhmen.

### 2.3 Metodologjia e Hulumtimit


Nga pikëpamja metodologjike ky studim kaloi përmes disa fazave të implementimit:

1. **Hulumtimi Sasior-** U përgatit një sondazh kombëtar me popullsinë (+18 vjec). Në total u plotësuan 1200 pyetësor (nga të cilat 200 vetëm për të rinjtë nga 18-24 vjeç).
2. **Hulumtimi Cilësor-** U organizuan 13 grupe diskutimi duke ndjekur një guidë moderimi me qëllimin për të zbuluar aspekte të tjera shtesë nga çështjet që trajtohen në pyetësor.
3. **Intervista të thelluara-** Si pjesë e komponentit cilësor të hulumtimit, IDRA organizoi 6 intervista në thellësi me aktorë të ndryshëm për të marrë përshtypje dhe sugjerime shtesë mbi mënyrat e përbaljes me fenomenin e pandëshkueshmërisë në Shqipëri.

## Sondazhi Sasior

### Kampioni i Përgjithshëm Publik

Sondazhi i përgjithshëm publik u bazua në disa faza. Probabiliteti rastësor u nxorr nga një listë qëndrash votimi të zgjedhjeve të fundit të përgjithshme në 2013. Për qëllime





kampionimi, Qëndrat e Votimit shërbejnë si njësi primare kampionimi. U zjodhën 196 Njësi Primare të Kampionimit duke përdorur një formulë e cila gjeneron numra në mënyrë të rastësishme duke marrë parasysh numrin e votuesve për cdo qendër votimi si dhe dimensionin urban kundrejt atij rural. Brënda zonës gjeografike të përcaktuar nga këto njësi të intervistuarit u zgjodhën në bazë të një

metode rastësore (u zgjodh cdo derë e tretë në të djathtë dhe personi mbi 18 vjeç me ditëlindjen e fundit në atë shtëpi u intervistua.)

### Shpërndarja Gjeografike e Kampionit

### Kampioni Shtesë i të Rinjve

U përzgjedh një kampion shtesë prej N=200 persona vetëm për të rinjtë (mosha 18-24 vjeç). Kampioni u përzgjedh në rang kombëtar me synimin për të qënë përfaqësues. Metoda e përzgjedhjes së shtëpive dhe të të intervistuarve është e njëjtë si ajo e sondazhit Publik të Përgjithshëm (rregull i krahut të djathtë, cdo derë e tretë, të intervistuarit me ditëlindjen e fundit)





### **Marzhi i Gabimit**

Marzhi i gabimit i kombinuar (duke përfshire kampionin shtesë për të rinjtë) është  $\pm 3,2\%$  me nje interval konfidence 95%. Teknikisht, një marzh gabimi  $\pm 3,2\%$  do të thotë se nëse studimi do të përsëritej me kampione të njëjta, 95% e tyre do të reflekton të dhënat nga popullata me një pasaktësi jo më të madhe se  $\pm 3,2\%$ . Testimi i domethënies statistikore e cila merr parasysh marzhin e gabimit është e rëndësishme vecanërisht për paraqitjen e nëngrupeve të analizës së rezultateve për këtë raport.

### **Komponenti Cilësor**

Një komponent cilësor u hartua në mënyrë që të eksploroheshin në detaje faktorët, perceptimi, si dhe mënyrat e sfidimit të fenomenit të pandëshkueshmërisë. Informacioni cilësor plotëson informacionin sasior nga studimi kombëtar. Në mënyrë që të merren parasysh të gjitha nuancat që rrjedhin nga mosha, statusi social apo vendodhja gjeografike e pjesëmarrësve, u organizua një shpërndarje e kujdesshme e grupeve të diskutimit, në bazë të përcaktimeve të mësipërme.

**Tabela e mëposhtme paraqet këtë ndarje:**

Nr.	Mosha	Gjinia	U/R	Qyteti
1	18+	Meshkuj/Femra	Rural	Tirane
2	18+	Meshkuj/Femra	Urban	Tirane
3	18+	Meshkuj/Femra	Urban	Tirane
4	18+	Meshkuj/Femra	Urban	Tirane
5	18+	Meshkuj/Femra	Urban	Tirane
6	18-29	Meshkuj/Femra	Urban	Tirane
7	18-29	Meshkuj/Femra	Urban/Rural	Fier
8	18+	Meshkuj/Femra	Urban	Fier
9	18+	Meshkuj/Femra	Rural	Fier
10	18+	Meshkuj/Femra	Rural	Fier
11	18-29	Meshkuj/Femra	Rural	Shkoder
12	18-+	Meshkuj/Femra	Urban	Shkoder
13	18+	Meshkuj/Femra	Rural	Shkoder

### **Intervistat në Thellësi**

Për të pasuruar informacionin e marrë nga sondazhi dhe grupet e fokusuara, me analizë profesionale për çështjet e ndryshme të prekura nga këto instrumente IDRA ka organizuar IDRA organizoi 6 intervista në thellësi me aktorë të ndryshëm të shoqërisë për çështjen e pandëshkueshmërisë.

Intervistat e thelluara garantojnë një qasje më profesionale mbi çështjet që lidhen kryesisht me arsyet e përhapjes së fenomenit të pandëshkëueshmërisë në Shqipëri, ndryshimet në kornizën ligjore të cilat kanë pasur si synim minimizimin e këtij fenomeni, si dhe përpjeket e shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare në këtë fushë.

Përmes intervistave të thelluara, është bërë e mundur paraqitja e një seti rekomandimesh si pjesë e raportit, të cilat synojnë të adresojnë disa nga çështjet kryesore në lidhje me fenomenin e pandëshkëueshmërisë në Shqipëri. Këto rekomandime, mund të shërbejnë si udhërrëfyes për punën e institucioneve përgjegjëse në luftën ndaj këtij fenomeni në Shqipëri.

Më specifikisht, intervistat në thellësi u organizuan me përfaqësues të Organizatave Ndërkombëtare të cilat operojnë në Shqipëri (2), si dhe me OJF në fushën e demokracisë dhe mirëqeverisjes (2) si edhe me avokatë dhe ekspertë ligjor (2).

#### **Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e Intervistave në thellësi sipas kategorive të mësipërme.**

<b>Kategoria</b>	<b>Nr.</b>
Avokatë/Ekspertë ligjor	2
OJF në fushën e demokracisë dhe mirëqeverisjes	2
Organizata Ndërkombëtare	2
Total	6

### 3. Gjetjet kryesore – Kampioni i popullatës së përgjithshme

#### 3.2 Informacion i Përgjithshëm

*Qytetarët shqiptarë mbeten të interesuar mbi zhvillimet sociale, politike apo ekonomike në vend, pavarësisht zhgënjimit të tyre me situatën e përgjithshme ekonomike, apo politike.*

Të pyetur se sa të interesuar janë për zhvillimet e ndryshme sociale, apo ekonomike në vend, 67% e të intervistuarve shprehen “më se shumti të interesuar” (26%) ose “shumë të interesuar” (33%). Ndërkohë, pothuajse 1 në 3 të intervistuar shprehet “jo shumë” apo “aspak i interesuar për këto zhvillime”. Përsa i përket ndarjes sipas gjinisë, rezultatet e sondazhit nuk tregojnë ndonjë diferencë të konsiderueshme midis opinionit të shprehur nga femrat kundrejt meshkujve. I vetmi ndryshim në këtë aspekt është numri paksa më i lartë (+8%) i femrave të cilat shprehen “shumë” ose “më të shumti të interesuara” për çështjet politike, sociale, apo ekonomike në krahasim me meshkujt.




Figura 1: Interesi për çështje Politike, Sociale, Ekonomike në vend

Rezultatet e sondazhit për interesin e qytetarëve për zhvillimet në vend konfirmohen edhe nga grupet e diskutimit. Shumica e pjesëmarrësve në këto grupe e konsiderojnë si domosdoshmëri nevojën për tu informuar rreth zhvillimeve në vend, kryesisht përsa i përket ekonomisë (punësimin, taksat, faturat mujore) dhe çështjeve sociale (arsimi, rendi, siguria).

*“Po, jam i interesuar, e ndjek vazhdimisht në varësi të kohës që kam, por që mundohem të jem koherent me ndodhinë, sidomos me politikën, ndërsa ekonominë më pak.”  
(Mashkull, Fier)*


*“Jemi punonjës të njëjse bashkiake dhe jemi në kontakt me problemet sociale në mënyrë të vazhdueshme dhe të përditëshme pasi jemi në sportele dhe kemi kontakte me njerezit gjate ditës së punës sonë. Absolutisht që jemi në kontakt dhe jemi të informuar dhe në brendësi të të gjitha problemeve dhe zhvillimeve.” (Mashkull, Tiranë)*

**Problemi më i madh me të cilin përballet aktualisht Shqipëria, sipas qytetareve, është Ekonomia. Ky dimension (Ekonomia/Papunësia/Varfëria) “eklipson” për nga rëndësia, cdo gjë tjetër në perceptimin e qytetarëve. Korrupsioni/Keq-qeverisja dhe Pandëshkueshmëria, janë gjithsesi probleme serioze të vendit.**

Rezultatet tregojnë se pothuajse 2 në 5 të intervistuar e konsiderojnë Ekonominë si problemin kryesor me të cilin përballet vendi. Po kaq shqetësim përbën papunësia, me rreth 37% të të intervistuarve të cilët e rendisin atë si sfidën e dytë më të rëndësishme në vend.

Rezultatet tregojnë gjithashtu se papunësia është më shumë problem për femrat në Shqipëri (40% e femrave e shohin si sfidën kryesore) krahasuar me meshkujt (29%). Ky rezultat vjen për shkak se përgjithësisht, mundësitë e punësimit për femrat në Shqipëri perceptohen si më të kufizuara se sa për meshkujt. Ndarja sipas zonave rurale, dhe urbane nuk tregon për ndonjë diferencë të madhe përsa i përket mendimit të të intervistuarve mbi sfidat kryesore me të cilat përballet vendi. Të intervistuarit në zonat urbane, ashtu si dhe ata në zonat rurale mendojnë se Ekonomia dhe Papunësia mbeten problemet kryesore të vendit, të ndjekur nga korrupsioni dhe keq-qeverisja. Grupet e diskutimit po ashtu nxorren në pah faktin se shumica e pjesëmarrësve i konsiderojnë ekonominë dhe papunësinë, problemet kryesore me të cilat përballet vendi. Sipas pjesëmarrësve, mungesa e mundësive për punësim dhe për rrjedhojë të të ardhurave të mjaftueshme për të përballuar jetesën, është sfida e tyre kryesore. Momentalisht punësimi konsiderohet si çështje tejet problematike edhe nga pjesëmarrësit e rinj në grupet e diskutimit. Të rinjtë përgjithësisht mendojnë se pas përfundimit të studimeve të larta, mundësitë për tu punësuar për ta janë tejet të pakta. Pjesëmarrësit e rinj shprehin gjithashtu shqetësimin e tyre gjithashtu mbi mangësitë e sistemit arsimor, kryesisht të korrupsionit

në këtë sektor, si dhe të pamundësisë së tyre për tu punësuar pasi përfundojnë studimet. Ndërkohë, pjesëmarrësit nga zona rurale, kryesisht shprehen të shqetësuar mbi mangësitë në infrastrukturë (furnizimi me uje, kanalet e vaditjes, etj.) në komunat ku jetojnë. Këto mangësi, sipas tyre, kufizojnë mundësitë e tyre për nxjerrjen e produkteve në treg dhe si rrjedhojë, ndikojnë në situatën e tyre ekonomike.




**Figura 2: Problemi më i madh me të cilin përballlet vendi**

*“Papunësia është problemi kryesor, se të themi që është mosarsimimi, arsimimi sot është, plot. Ka shumë njerëz të arsimuar, por të gjithë i ke të papunë.” (Femer, Fier)*

*“Sfida kryesore në ditët e sotme është punësimi në radhë të parë. Vetëm nëse ulim nivelin e papunësisë mund të fitojmë një mirëqenie të përgjithshme, jo aq të lartë por sa për mbulimin e nevojave minimale të popullatës. Është arsimi ai që shkon paralel më pas me ekonominë, me hapjen e vendeve të reja të punës. Dhe politika sigurisht jep dorën kryesore rregullimit të gjithë këtyre sistemeve.” (Mashkull Tiranë)*

*“Problemet janë të shumta sidomos në fshat. Në fshat kanalizimi për ujërat e zeza nuk ka, ka papastërti.” (Fier/Fermer, Mashkull)*



**Figura 3: Problemet e qytetarëve**

*“Pandëshkueshmëria është e rëndësishme për mua, por dhe korrupsioni gjithashtu se duke qënë se unë nuk ndëshkohem korruptohem, të dyja këto kanë lidhje.” (Femër, Fier)*

Përsa i përket korrupsionit, dhe keqqueverisjes, ajo që duhet nënvizuar është se këto çështje identifikohen si sfida nga qytetarët gjatë sondazhit vetëm kur këta të fundit pyeten specifikisht për to. Ndërsa, kur qytetarëve u duhet të përmendin vetë sfidat kryesore, vihet re që këto dy çështje nuk janë prioritete për qytetarët shqiptarë. Rreth dy herë më shumë meshkuj e konsiderojnë korrupsionin/keqqueverisjen si problemin kryesor (14%) krahasuar me të intervistuarat femra. Specifikisht, të pyetur se sa problem janë çështjet e ndryshme momentalisht për ta, 89% e të intervistuarve e shohin ekonominë si “shumë problem”, të ndjekur nga 85% të cilët mendojnë se korrupsioni është “shume problem”. Gjithashtu, shumica dërrmuese e të intervistuarve e konsiderojnë fenomenin e Pandëshkueshmërisë si “shumë problem”( 74%), dhe “deri diku problem” (22%) për ta personalisht. Përsa i përket ndarjes gjinore, nuk ka diferencë të theksuara të vlerësimit të dhënë nga femrat dhe meshkujt mbi sa problematike janë çështjet e listuara më sipër. Grupet e diskutimit, gjithashtu nxorën në pah faktin se shumica e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit shohin po ashtu Korrupsionin dhe Pandëshkueshmërinë si tejet problematike për ta dhe familjet e tyre. Pjesëmarrësit, shprehin shqetësimin e tyre mbi faktin se korrupsioni dhe keq-queverisja është shpesh pengesë për ta, për të gjetur një vend pune, apo për të vazhduar studimet në një degë të caktuar.

### 3.3 Burimet e informacionit dhe Aktivizimi qytetar

*Televizioni, bisedat me miqtë dhe familjen, si dhe gazetat janë burimet kryesore të informacionit për shumicën e qytetarëve në vend, pavarësisht moshës apo vendodhjes (Urban/Rural)*

Të pyetur mbi burimet e informacionit mbi zhvillimet sociale, ekonomike apo politike në vend, televizioni është burimi kryesor i përmendur nga pothuajse 9 nga 10 të intervistuar. Ndërkohë, bisedat me miqtë apo komshinjtë për të mësuar zhvillimet e fundit (1 në 2), si dhe gazetatat (1 në 3), rezultojnë të jenë opsioni i dytë dhe i tretë respektivisht nga qytetarët për të marrë informacionin e nevojshëm. Rezultatet tregojnë gjithashtu se numri i të intervistuarve që deklarojnë se përdorin rrjetet sociale si burim të parë të informacionit është relativisht i vogël krahasur me opsionet e tjera. Si për të intervistuarit në zonat urbane, ashtu edhe për ata në zonat rurale, televizioni, dhe bisedat me miqtë, mbeten dy nga burimet kryesore për tu informuar mbi zhvillimet në vend. Përsa i përket ndarjes gjinore, nuk ka diferencë domethënëse midis femrave dhe meshkujve përse i përket burimeve që përdoren për tu informuar.




Figura 4: Burimet e Informacionit

“Media, interneti, gazetat, familje, shoqëri [janë burimet kryesore të informacionit] sepse normalisht bisedojmë për çështje të ndryshme që na prekin.” (Tiranë, Mashkull)

Pjesëmarrësit në grupet e diskutimit gjithashtu konfirmojnë faktin se burimet kryesore për informim në familjen e tyre janë televizioni.. Ndërkohë, në bazë të diskutimeve gjatë këtyre grupeve, veçanërisht grupet e të rinjve, shihet se interneti përdoret më shpesh si burim informacioni nga të rinjtë, krahasur me pjesën tjetër të popullatës. Pavarësisht kësaj, për shumicën e pjesëmarrësve, përvojat personale janë gjithashtu një burim mjaft i rëndësishëm për t’u informuar mbi gjëndjen e sektorëve të ndryshëm në vend (shëndetësi, arsim, punësim, bujqësi etj.) Pjesëmarrësit vlerësojnë edhe bisedat me miqtë, të njohur, familjarë si një burim po kaq të rëndësishëm informimi mbi zhvillimet në vend. Si rrjedhojë, një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve, sidomos në zonat rurale, ku burimet alternative të informacionit përveç televizionit janë të kufizuara, shprehen se bisedat me miqtë, apo të afërmin e tyre u shërbejnë shpesh për tu përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Shqipëri.

**Momentalisht, Media, konsiderohet gjërësisht nga qytetarët shqiptarë si aktori më i suksesshëm në hetimin dhe raportimin e shkeljeve të ligjit nga zyrtarët e lartë publik. Ndërkohë, pavarësisht se Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, si dhe institucionet e tjera teorikisht duhet të jenë në radhën e parë përse i përket luftës ndaj pandëshkueshmërisë, performanca e tyre nuk vlerësohet si mjaftueshëmrisht pozitive nga qytetarët Shqiptar.**




Figura 5: Aktorët më të suksesshëm në investigimin dhe raportimin e shkeljeve të ligjit nga zyrtarët e lartë në Shqipëri



Të pyetur se cilin aktor konsiderojnë aktualisht si më të sukseshëm në investigimin dhe raportimin e shkeljeve të ligjit nga zyrtarët e lartë në Shqipëri, pothuajse 4 në 5 të intervistuar rendisin Median si të tillë


Ndërkohë, Policia e Shtetit (42%), vetë qytetarët (27%) si dhe Shoqëria civile (20%) shihen gjithashtu si aktorë relativisht të rëndësishëm në këtë aspekt. Ajo ç'farë duhet theksuar, është fakti se rezultatet tregojnë se institucione si Prokuroria e Përgjithshme, e cila konsiderohet si përgjegjëse për investigimin e çështjeve të tilla, konsiderohet si e sukseshme në këtë aspekt nga vetëm 1 në 5 të intervistuar. Rezultatet e sondazhit konfirmohen edhe nga grupet e diskutimit, gjatë së cilave pjesëmarrësit e vlerësojnë punën e Medias si relativisht të sukseshme përsa i përket raportimit dhe hetimit të rasteve të abuzimit nga zyrtarët.

***Media shihet nga qytetarët shqiptar si aktor i rëndësishëm dhe efektiv në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, ekziston një perceptim i përhapur në publik se media është nën presionin e vazhdueshëm politik dhe ekonomik, që shpesh e pengon atë në veprimtarinë e përditshme. Mediat me një qasje kritike ndaj qeverisë shihen si veçanërisht të kërcënuara nga ndërhyrje të tilla.***

Rezultatet e sondazhit tregojnë se shumica e qytetarëve të intervistuar (69%) “pajtohen” me pohimin se Media në Shqipëri në përgjithësi bën një punë të mirë në raportimin e shkeljeve nga personat me pushtet. Puna e mirë e medias në raportimin e abuzimeve nga zyrtarët e lartë publik, vlerësohet edhe nga pjesëmarrësit në grupet e diskutimit. Shumica e pjesëmarrësve vlerësojnë informacionin e ofruar nga media vendase për raste të ndryshme të shkeljeve nga zyrtarët e lartë. Disa pjesëmarrës gjithashtu vlerësojnë profesionalizmin e medias dhe gazetarëve shqiptarë, si dhe zhvillimin e medias (kryesisht televizione) gjatë viteve të fundit.

Megjithatë, rezultatet e sondazhit tregojnë gjithashtu për një perceptim gjerësith të përhapur në publik se media në Shqipëri është nën ndikimin e pushteveve politike dhe ekonomike. Kështu, rreth 62% të intervistuar “pajtohen” me pohimin sipas të cilit Media në Shqipëri është e kufizuar nga interesa ekonomiko-politike që pengojnë raportimin e këtyre rasteve. Ndërkohë, perceptimi se zyrtarët e lartë në Shqipëri ushtrojnë presione mbi median për të mos raportuar çështjet e abuzimit nga zyrtarë të lartë publik është mjaft i përhapur, me 63% të të intervistuarve të cilët bien dakord me këtë pohim. Mediat pranë qeverisë shihen si përgjithësisht të privileguara nga pak më shumë se gjysma e të intervistuarve (57%), ndërsa po kështu, shumica e të intervistuarve (64%) mendon se mediat me qasje kritike ndaj qeverisë ndodhen nën presion të vazhdueshëm ekonomik ose politik. Rezultatet nuk tregojnë ndonjë diferencë të konsiderueshme midis të intervistuarve në zonat rurale, apo atyre në zonat urbane. Grupet e diskutimit i vërtetojnë gjetjet e sondazhit përsa i përket rolit të medias në Shqipëri.

Pjesëmarrësit shprehen se influencat politike, ekonomike, si dhe lidhjet e biznesit apo edhe njohjet e pronarëve të medias bëhen shpesh pengesë për punën e gazetarëve në Shqipëri. Shumë prej këtyre pjesëmarrësve mendojnë se ka një ndarje të qartë dhe lehtësisht të dallueshme midis mediave (kryesisht televizionet), bazuar në preferencat e tyre politike. Si rrjedhojë, sipas pjesëmarrësve, informacioni që merret nga këto burime, pavarësisht se mund të konsiderohet i bollshëm, ka mangësi të mëdha përsa i përket paanshmërisë së raportimit që bëhet në publik në varësi të medias që raporton.




**Figura 6: Vlerësime mbi Median**

*“Problemi është se [mediat] nuk janë plotësisht të besueshme sepse disa janë të politizuara. Një lajm e degjon ndryshe diku e ndryshe diku tjetër.” (Femër, Tiranë)*

**Qytetarët të cilët janë përballur me shkelje të ndryshme ligjore, në pak raste kanë përdorur instrumenta për të raportuar këto shkelje.**

Gjetjet e sondazhit tregojnë se vetëm 1 në 10 të intervistuar kanë “kontaktuar apo takuar një zyrtar publik të çdo niveli” të qeverisë për të denoncuar një rast abuzimi, ndërkohë që pothuajse po kaq “kanë nënshkruar një peticion apo dërguar një e-mail” për këtë qëllim.

Ndërkohë, ajo çfarë është e rëndësishme të theksohet, është se në rezultatet tregojnë se pavarësisht përvojës reale (ç’farë ndodh në të vërtetë), të pyetur mbi gatishmërinë për të përdorur instrumenta të ndryshme për të raportuar shkeljet ligjore, një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve shprehet pozitivisht. Specifikisht, rreth 3 në 5 të intervistuar do të ishin të gatshëm të “telefononin në një program televiziv” për të denoncuar një rast abuzimi, ndërkohë që 1 në 2 do të “kontaktonin një zyrtar publik të çdo niveli të qeverisë” për të denoncuar raste të tilla. Në grafikun e mëposhtëm, (Fig.7), paraqitet vetëm gatishmëria e të intervistuarve të cilët nuk kanë përdorur asnjë nga instrumentat e mëposhtëm për të denoncuar shkelje ligjore.



**Figura 7: Gatishmëria për të denoncuar shkeljet ligjore, abuzime, etj.**

Ndërkohë, denoncimi përmes rrjeteve sociale (57% nuk do ta bënin kurrë) si dhe dërgimi një mesazhi tek ndonjë media apo ndonjë zyrtari (45% nuk do ta bënin kurrë) janë instrumentat të cilat kanë më pak gjasa për tu përdorur nga të intervistuarit.

*“Nuk mund të them as po as jo po nqs nuk do më prekte drejtpërdrejt nuk besoj se do ta raportoja megjithëse do të më pëlqente që të bëja diçka pozitive. Nqs do të bëhej fjalë për një dhunë në familje do të raportoja patjetër.” (Mashkull, Shkodër)*

*“Nuk besoj se njerëzit i raportojnë këto ngjarje sepse mendojnë se nuk kanë mbrojtje.” (Femër, Fier)*

*“Unë personalisht do ta bëja [raportoja një ngjarje të tillë], por vetëm nëse do të isha i sigurt që do të përgjigjeshin policia apo organet përkatëse.” (Tiranë, Mashkull)*

### 3.4 Pandëshkueshmëria

***Ekziston një kontrast i thellë midis asaj çfarë mendojnë qytetarët përsa i përket mundësisë që ata vetë të ndëshkohen për shkelje ligjore dhe asaj që ata mendojnë se ndodh me një zyrtar të lartë për të njëjtat shkelje. Shumica e qytetarëve e shohin mundësinë e ndëshkimit të zyrtarëve të lartë si shumë të ulët, duke nënkuptuar kështu faktin që sipas tyre, ligji nuk është i barabartë për të gjithë.***

Për të matur perceptimin e publikut mbi nivelin e ndëshkueshmërisë/pandëshkueshmërisë së këtyre shkeljeve në Shqipëri, si edhe tolerancën e opinionit publik përsa i përket shkeljeve të ndryshme ligjore, të intervistuarve u janë paraqitur , 6 skenare të ndryshëm.

1. Falsifikimi i dokumentave
2. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor
3. Kryerja e evazionit fiskal
4. Abuzimi me vëndin e punës
5. Ndërhyrja për të punësuar një të afërm, të njohur
6. Pagesa nën dorë në një institucion


Për çdo skenar, të intervistuarve u është kërkuar të japin një vlerësim mbi mundësitë që ekzistojnë që ata personalisht/zyrtarët e lartë të ndëshkohen nëse bëjnë ndonjë nga shkeljet e paraqitura. Të intervistuarit kanë dhënë vlerësimet e tyre në një shkallë nga 1 në 4, ku 1 = “ ka shumë mundësi që të ndëshkohem/t”, dhe 4 = “Nuk ka aspak mundësi” që të ndëshkohem/t.

*Pyetja që ju është drejtuar të intervistuarve është:*


*A mund të më thoni se sa e mundshme është që ju të kapeni dhe të dënoheni nëse bëni ndonjë nga shkeljet e mëposhtme në një shkallë nga “Aspak mundësi” për tu ndëshkuar deri në “Shumë mundësi” për tu ndëshkuar.*

Për të lehtësuar analizimin statistikor të rezultateve është bërë një konvertim i rezultateve nga shkalla 1-10, për të kaluar në një shkallë nga 0-100. Në këtë shkallë, 0 do të thotë “Aspak mundësi” dhe 100 do të thotë “Shumë mundësi” që qytetari/zyrtari i lartë të kapet dhe të dënohet.

Rezultatet e sondazhit nxjerrin në pah një ndryshim të konsiderueshëm midis perceptimit të qytetarëve mbi mundësite e ndëshkimit të shkeljeve të tyre ligjore, krahasuar me ato të zyrtarëve të lartë. Kështu, indeksi i pandëshkueshmërisë për qytetarët shënon 62 pikë nga 100 të mundshme, ku 0=“Aspak mundësi të ndëshkohen” dhe 100= “Shumë mundësi të ndëshkohen”. Ndërkohë, indeksi i pandëshkueshmërisë për zyrtarët e lartë, vlerësohet vetëm me 25 pikë nga 100 të mundshme.



**Figura 8: Indeksi i Pandëshkueshmërisë Personale**



**Figura 9: Indeksi i Pandëshkueshmërisë për Zyrtarët e Lartë**

Më specifikisht, për shumicën e të intervistuarve, mundësitë që këta të kapen dhe të dënohen nëse bëjnë një shkelje ligjore janë përgjithësisht të mëdha. Kështu, “shkelja e rregullave të qarkullimit” si dhe “falsifikimi i dokumentave” janë vlerësuar respektivisht me 70 dhe 73 pikë nga 100 të mundshme. Këto rezultate tregojnë se shumica e të intervistuarit mendojnë se gjasat që ata të kapen dhe të dënohen nëse do të ishin të përfshirë në këto skenare janë mjaft të larta. Pjesëmarrësit në grupet ediskutimit vërtetuan gjetjet e sondazhit në terren, duke u shprehur se përsa i përket qytetarëve të thjeshtë ( qytetarët të cilët nuk kanë ndonjë post publik të rëndësishëm), si dhe atyre të cilët nuk kanë njohje të cilat mund të influencojnë në institucionet shtetërore, ligji zbatohet në mënyrë të përpiktë, dukë i ndëshkuar ata.


Ndërkohë, të pyetur rreth mundësive që për të njëjtat shkelje si më sipër, tashmë një zyrtar i lartë të kapet dhe të dënohet, shumica e të intervistuarve shprehen skeptikë. Kështu, në indeksin e Pandëshkueshmërisë për Zyrtarët e lartë, “Pagesat në dorë në një institucion shtetëror”, si dhe “Ndërhyrja për të punësuar një të afërm” shënojnë respektivisht 19 dhe 20 pikë nga 100 të mundshme. Rezultatet tregojnë se sipas të intervistuarve, mundësitë që zyrtarë të përfshirë në këto dy skenarë të dënohen janë mjaft të ulëta. Pjesëmarrësit në grupet e diskutimit shprehen gjithashtu skeptik rreth mundësisë së dënimit të një zyrtari të lartë nëse kryen shkelje ligjore të ndryshme.

Pjesëmarrësit mendojnë se zyrtarët e lartë ushtrojnë influencën e tyre mbi institucionet ligjzbatuese, në mënyrë që hetimet ndaj tyre ose të mos nisin fare, ose që hetimet të mos çojnë asnjëherë në një përfundim konkret. Si rrjedhojë, shumica e pjesëmarrësve pretendojnë se besimi i tyre tek barazia e qytetarëve përballë ligjit është çënuar ndjeshëm, për shkak të mungesës së dënimit të ndonjë zyrtari të lartë në 20 vitet e fundit në Shqipëri.

*“Për mendimin tim siç e thashë dhe më parë, problemi nuk qëndron tek paaftësia por tek pavarësia e këtyre institucioneve, organet gjyqësore nuk janë të pavarura por janë të varura nga lart, nga politika, çka presim ne më prej tyre. Ata nuk mund të dënojnë, fëmijët apo niprit e politikanëve, apo atyre që ua kanë dhënë këtë pozicion.” (Fier, Urban)*

Të pyetur mbi gatishmërinë e tyre për të raportuar shkelje të ndryshme ligjore nëse do të ishin dëshmitarë, rezultatet tregojnë për një gatishmëri më të madhe të të intervistuarve për të raportuar ngjarje të cilat nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë me ta. Kështu, rreth 60% e të intervistuarve shprehen “shumë të gatshëm” për të raportuar një grabitje me dhunë të një personi tjetër. Ndërkohë, një numër më i vogël i të intervistuarve shprehet “shumë i gatshëm” për të raportuar rastet kur mundësitë që të ndeshen me personin që denoncojnë janë më të mëdhaja si në rastet kur “janë në dijeni të dokumentave të falsifikuara nga eprori/kolegu” (40%), apo “janë në dijeni të manipulimeve me një proces tenderimi në kompaninë e tyre” (36%). Gjetjet e sondazhit vërtetohen edhe nga grupet e diskutimit. Pjesëmarrësit në këto grupe shprehin një lloj hezitimi për të denoncuar rastet e ndryshme të abuzimit, sidomos nga kolegët dhe eprorët e pjesëmarrësve. Përsa i përket eprorëve, shumica e pjesëmarrësve shprehen se nuk do të ishin të gatshëm ta raportonin një abuzim të tyre për shkak të frikës se kjo do të çonte në ndëshkimin/pushimin e tyre nga puna. Gjithashtu pjesëmarrësit nuk kanë besim se denoncimi i tyre do të sillte një ndryshim të situatës, për arsye të influencës që mund të ketë eprori i tyre në institucionet ligjzbatuese. Megjithatë, përsa i përket raportimit të grabitjeve me dhunë apo shkelje të tjera të këtij lloji, ndryshe nga gjetjet e sondazhit, shumë pjesëmarrës shprehen deri diku të pasigurtë dhe nuk besojnë se anonimiteti i tyre do të ruhej nga Policia e Shtetit nëse do të raportonin një skenar të tillë. Për rrjedhojë, shumë pak prej pjesëmarrësve shprehen të gatshëm të njoftojnë Policinë e Shtetit për raste të tilla.

Rezultatet nxjerrin në pah një lloj mospërputhje midis dëshirës së qytetarëve për rritjen e nivelit të ndëshkueshmërisë për shkelje të ndryshme ligjore, dhe qëndrimit të tyre apatik, për disa prej këtyre shkeljeve. Kështu, vetëm 1 në 3 të intervistuar është i gatshëm të raportojnë rastet kur një “koleg i tyre ndërhyr për të siguruar një vend pune për një të afërm”.



**Figura 10: Gatishmëria për të raportuar shkelje ligjore**

*“[Nëse do ishit dëshmitar i një abuzimi nga eprori juaj, do ta raportoni?] Varet sesa besim kemi që mund të dëgjohet fjala jonë. Varet nga fuqia që ka eprori ynë. Nëse një epror ka një fuqi të madhe që sado ta raportoj s’bëj dot gjë atëhere nuk do ta raportoja se vetëm i prish punë vetes. (Fier, Urban)*

*“[Nëse do ishit dëshmitar i një abuzimi nga eprori juaj, do ta raportoni?] Nuk e di varet, nëse do të kishte lidhje me mua do ta bëja por nëse nuk kishte nuk e bëj dot se nuk e di sa përkrashje do të kem, se mund të më nxirrnin nga puna pastaj.” (Fier, Rural)*

**Pandëshkueshmëria shihet nga shumica e qytetarëve si një fenomen që është jashtëzakonisht i përhapur në Shqipëri. Mungesa e shëmbujve konkret të të dënuarve mes zyrtarëve të lartë, ka sjellë humbjen e besimit të qytetarëve se ligji është i njëjtë për të gjithë në Shqipëri. Korrupsioni, moszbatimi i ligjeve dhe i rregullave, si dhe mosfunksionimi i sistemit të drejtësisë shihen si arsyet kryesore që kanë ndikuar në përhapjen e fenomenit të Pandëshkueshmërisë në Shqipëri.**


Shumica e qytetarëve të intervistuar e shohin fenomenin e Pandëshkueshmërisë në Shqipëri të lidhur me mungesën e ndëshkimit për shkeljet ligjore dhe abuzimet me detyrën, kryesisht nga zyrtarët e lartë. Parimi i barazisë përballë ligjit, pavarësisht statusit social, ekonomik, sipas qytetarëve, nuk zbatohet në praktikën e përditshme nga organet ligjzbatuese në Shqipëri. Si rrjedhojë, sipas qytetarëve, shumë individë apo grupe



individësh me influencë politike dhe ekonomike arrijnë tu shmangen përballjes me ligjin edhe pas përfshirjes së tyre në shkelje të ndryshme.

*Mendoj që pandëshkueshmëria është mos ndëshkimi i një shkelje ligjore sidomos nga ana e prokurorëve apo gjyqtarëve. Mosndëshkimi i një shkelje ligjore të tillë sjell pasoja të popullit.” (Tiranë, Rural)*

*“Cdo njëri që bën një veprim të kundraligjshëm duhet të ndëshkohet. Nëse në asnjë hallkë nuk ndëshkohet kjo është pandëshkueshmëria. (Tiranë, Urban)*



**Figura 11: Perceptimi mbi Pandëshkueshmërinë**

Të pyetur mbi perceptimin e tyre për përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri, pothuajse 7 në 10 të intervistuar mendojnë se Pandëshkueshmëria është një fenomen që është mjaft i përhapur. Rreth dy herë më pak (28%) të intervistuar mendojnë nga ana tjetër që ky fenomen është deri diku i përhapur në vend. Numri i atyre të cilët mendojnë se ky fenomen nuk ekziston në Shqipëri është i papërfillshëm.

Gjetjet e sondazhit në terren u përforcuan nga ato cfarë pjesëmarrësit shprehin gjatë grupeve të diskutimit përsa i përket këtij fenomeni. Shumica e pjesëmarrësve shprehen se fenomeni i pandëshkueshmërisë është mjaft i përhapur në vend, sidomos në sektorin publik. Përsa i përket sektorit privat, pjesëmarrësit mendojnë se fenomeni është më pak i përhapur për shkak të faktit se kompanitë private kanë prirjen të ndëshkojnë gabimet/shkeljet më tepër për arsye të dëmit të shkaktuar tek të ardhurat. Ndërkohë shumica e pjesëmarrësve e shohin sektorin publik si “mall pa zot”, dhe ku shkeljet nuk ndëshkohen nga askush.

Përsa i përket arsyeve të përhapjes së fenomenit të Pandëshkueshmërisë, pjesëmarrësit rendisin korrupsionin, influencën politike, mosfunksionimin e sistemit gjyqësor si dhe lidhjet e zyrtarëve të lartë me bizneset si më kryesoret. Fakti që pavarësisht se janë hapur disa çështje penale ndaj zyrtarëve të lartë, por që ende sot pas 20 vitesh ende nuk ka asnje zyrtar të lartë të dënuar, ka cënuar rëndë besimin tek qytetarët se ligji është i barabartë për të gjithë në Shqipëri. Pjesëmarrësit fajësojnë kryesisht sistemin gjyqësor, i cili shihet si i korruptuar, dhe me mangësi të theksuara, duke ndikuar kështu në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend, kryesisht për individët që gëzojnë pushtet politik apo ekonomik.


*“Unë do ta konsideroja si fenomen që ka të bëjë me mosmarrjen e sanksioneve ligjore, civile, penale për një shkelje të caktuar qoftë edhe nëse nuk parashikohet në kodin ligjor, qoftë edhe kur kemi të bëjmë me një normë shoqërore.” (Mashkull, Tiranë)*

*“Unë e shoh pandëshkueshmërinë të lidhur ngushtë me korrupsionin. Një njeri që nuk ndëshkohet patjetër ja ka gjetur anën nëpërmjet rryshfetit.” (Femër, Tiranë)*

Përsa i përket perceptimit mbi përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri, përfaqësuesit e ndryshëm të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, si dhe ekspertëve në fushën e avokatisë të intervistuar, ndajnë pothuajse të njëjtin mendim. Të intervistuarit nga këto kategori shprehën shqetësimin e tyre për përhapjen në masë të këtij fenomeni në vend, duke e konsideruar atë si një nga faktorët kryesorë i cili pengon zhvillimin e vendit si në aspektin social, ashtu dhe në atë ekonomik. Gjatë intervistave të thëlluara, disa prej ekspertëve pretendojnë se hasen shpesh me fenomenin gjatë ushtrimit të aktivitetit/profesionit në Shqipëri. Kështu, të intervistuarit në fushën e avokatisë e shohin pandëshkueshmërinë si një fenomen të zakonshëm gjatë punës së tyre të përditshme në marrëdhëniet me gjykatat. Sipas tyre, shumë herë u është dashur të përballen me influencat politike, apo korruptive të cilat synojnë të shërbejnë si mburoje për të akuzuarit, vecanërisht kur këta të fundit janë njerëz me pushtet. Ekspertët e intervistuar mendojnë se një perceptim i tillë në publik për përhapjen e nivelit të pandëshkueshmërisë vjen edhe si rrjedhojë e përvojave të mëparshme negative, sidomos përsa i përket përfshirjes së zyrtarëve të lartë në shkelje

ligjore, dhe aktivitete të jashtëligjshme. Si rrjedhojë, ekspertët e intervistuar mendojnë se fenomeni i pandëshkueshmërisë është ende mjaft i përhapur në Shqipëri, kryesisht si rrjedhojë e paaftësisë së sistemit gjyqësor si dhe mangësive profesionale dhe financiare të institucioneve të tjera ligjzbatuese. Përjashtim bëjnë disa përfaqësues të shoqërisë civile të intervistuar të cilët gjithsesi shohin një ndryshim të qasjes së pushtetit ekzekutiv për zbatimin e ligjit në terren, shpesh, sipas tyre, edhe përmes metodave “shtrënguese dhe jo shumë demokratike.”

Të pyetur mbi rëndësinë që kanë faktorët e ndryshëm në ekzistencën dhe përhapjen e fenomenit të Pandëshkueshmërisë në Shqipëri, shumica e të intervistuarve (78%) vlerësojnë Korrupsionin si “shumë të rëndësishëm”, të ndjekur nga 74% të cilët po ashtu vlerësojnë “moszbatimin e ligjeve dhe rregullave” si “shumë të rëndësishëm” në këtë aspekt, si dhe 72% të cilët e shohin “mosfunksionimin e sistemit të drejtësisë” po aq të rëndësishëm. Të intervistuarit që mendojnë se mangësitë në kornizën ligjore janë faktor “shumë i rëndësishëm” në këtë aspekt janë relativisht më të paktë në numër (34%).



**Figura 12: Rëndësia e faktorëve të ndryshëm në përhapjen dhe ekzistencën e Pandëshkueshmërisë**

Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit gjithashtu mendon se mangësitë ligjore, nuk janë arsyeja kryesore se pse Pandëshkueshmëria është përhapur si fenomen në Shqipëri. Sipas mendimit të tyre, korniza ligjore në Shqipëri është mjaftueshëm e plotë, por ligji nuk zbatohet siç duhet nga institucionet përgjegjëse, duke mos i trajtuar të gjithë si të barabartë.

*“[Cilët janë faktorët që ndikojnë në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë?] Ka dhe keqinterpretim të ligjit ose përdorim ligji në bazë interesi. Janë shumë të pakta rastet kur mangësitë e ligjit ndikojnë.” (Tiranë, Urban)*

Në të njëjtën kohë, ekspertët e intervistuar shohin politizimin ekstrem ndër vite, si dhe mangësitë profesionale të administratës publike si faktor shtesë që ka ndikuar në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend.

Ndërkohë, shoqëria civile si dhe përfaqësuesit e disa prej organizatave ndërkombëtare të cilat kryejnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, gjatë intervistave të thëlluara janë shprehur gjithashtu mbi arsyet e përhapjes së fenomenit të pandëshkueshmërisë. Ndër faktorët të cilët listohen si më të rëndësishëmit në përhapjen e këtij fenomeni nga të intervistuarit janë paaftësia (financiare, ligjore) e institucioneve përgjegjëse për të ushtruar kompetencat e tyre, shëmbulli i keq i ofruar nga vetë zyrtarët publik, korrupsioni, konfliktet e interesit si dhe militantizmi në administratën publike. Më specifikisht, disa prej ekspertëve ligjor të intervistuar mendojnë së i duhet kushtuar një vëmendje e veçantë procesit të përshtatjes të legjislacionit vendas me atë European, në kuadër të procesit të integritimit. Shpesh, sipas tyre, konteksti, burimet financiare dhe njerëzore në vend nuk merren parasysh gjatë hartimit të kornizës ligjore, duke ndikuar kështu negativisht në efektshmërinë e masave dhe reformave në terren.

Përsa i përket fuqizimit të administratës publike, si dhe institucioneve të tjerat ë rëndësime në vend, disa prej përfaqësuesve të shoqërisë civile mendojnë se duhet të rriten kërkesat dhe metodat e vlerësimit për kapacitetet profesionale, si dhe për integritetin e personave të cilët punësohen në administratën publike, sistemin gjyqësor, strukturat e Policisë së Shtetit, etj. Një tjetër shqetësim i shprehur nga përfaqësuesit e shoqërisë civile të intervistuar është edhe mungesa e zbatimit të ligjit mbi përgjegjësinë individuale, kryesisht përsa i përket zyrtarëve publik. Specifikisht, ky ligj, parashikon që barra e shlyerjes së dëmeve monetare apo materiale të shkaktuara nga veprimet apo mosveprimet e titullarit të institucionit, gjatë ushtrimit të detyrës, të përballahohen nga vetë titullari përgjegjës, dhe jo nga institucioni. Në parim, sipas të intervistuarve, kjo dispozitë ligjore duhet të frenonte abuzimet e shpeshta të zyrtarëve publik me pozicionin e tyre drejtues në institucione të rëndësishme, duke rritur kështu masën e ndëshkueshmërisë për këta të fundit. Në të vërtetë, përvoja në vend ka treguar ,se pothuajse në asnjë rast, ky ligj nuk është zbatuar.

Përsa i përket organizatave ndërkombëtare që kryejnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, disa prej përfaqësuesve të intervistuar besojnë se aplikimi i standardave të dyfishta nga institucionet ligjzbatuese, përsa i përket zbatimit të legjislacionit dhe reformave në terrën, është një prej shkaqeve kryesore të përhapjes së pandëshkueshmërisë në vend. Pavarësisht përpjekjeve aktuale, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare mendojnë se nisur nga sistemi aktual i organizimit dhe funksionimit të politikës në përgjithësi, dhe partive politike në veçanti, do të duhet shumë punë dhe një kohë e gjatë për të minimizuar përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri. Fakti që partitë politike funksionojnë në një sistem të mbyllur, ku meritokracia nuk është kushti parësor për promovim, është një nga aspektet më negative të politikës sipas të intervistuarit. Të përzgjedhurit në rangjet e larta të partive përmes këtij sistemi, caktohen në pozita të rëndësishme shtetërore kur partitë fitojnë zgjedhjet. Si rrjedhojë, është shumë e vështirë që këta të fundit të japin llogari përballë publikut, sepse publiku nuk është ai që i ka zgjedhur në atë post të rëndësishëm.

Metodat që duhet të përdoren për të adresuar fenomenin e pandëshkueshmërisë në vend, sipas të intervistuarve, duhet të jenë një ndërthurje e vullnetit politik dhe institucional, fuqizimit konkret të institucioneve/enteve të cilat garantojnë zbatueshmërinë e ligjit, si dhe ngushtimin e hapësirave për ndërhyrjet dhe influencat politike dhe ekonomike tek veprimtaria e këtyre institucioneve. Përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare të cilat operojnë në Shqipëri shprehën gjatë intervistave, se edukimi i hershëm mbi mekanizmat ekzistues ose të mundshme të monitorimit të punës së institucioneve publike, si dhe efekteve negative të pandëshkueshmërisë mund të jetë një mjet shumë i rëndësishëm në luftën ndaj këtij fenomeni në vend. Për më tepër, të intervistuarit ndajnë pothuajse të njëjtat pritshmëri nga institucionet përsa i përket nevojës për të aplikuar standarde të njëjta gjatë zbatimit të reformave në terrën. Një qasje e tillë, sipas këtyre ekspertëve do të rriste besimin e publikut tek institucionet publike, duke rritur kështu mundësitë e bashkëpunimit me qytetarët. Një mekanizëm i tillë bashkëpunimi, shihet prej të intervistuarve si një mekanizëm mjaft efektiv dhe premtues në luftën kundër përhapjes së fenomenit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri.

### 3.5 Indeksi i Pandëshkueshmërisë

Për të bërë të mundur përfitimim e një indeksi të pandëshkueshmërisë personale, si dhe për zyrtarët e lartë, të intervistuarve ju parashtuan 10 skenare të ndryshme të cilët përmbanin shkelje të ndryshme ligjore. Për secilin skenar, janë paraqitur disa pyetje specifike, përmes të cilave do të mund të përfitohej një vlerësim i të intervistuarve për atë çfarë përbën shkelje ligjore dhe si rrjedhojë do të duhej të ndëshkohej. Skenarët janë paraqitur në vijim:

**SKENARI 1:** Nje zyrtar i lartë i administratës publike pranon një shumë parash për të favorizuar një kompani të caktuar në një proces tenderimi.

**SKENARI 2:** Një zyrtar i administratës publike përdor automjetin e administratës për çështje personale, familjare.

**SKENARI 3:** Një mjek në spitalin publik, pasi i ka ofruar shërbimin shëndetësor pacientit merr një shumë parash të ofruar nga ky i fundit.

**SKENARI 4:** Si rezultat i një kontrolli, një Zyrtar LOKAL është gjetur se ka dhënë një leje apo licencë në menyrë të paligjshme për përfitime personale, psh. një leje ndërtimi të paligjshme për një kompani që i përket një anëtarit të familjes.

**SKENARI 5:** Një student në universitetin publik ka ofruar para për të marrë një notë kaluese gjatë vitit shkollor, dhe pedagogu në fjalë i ka pranuar këto para.

**SKENARI 6:** Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit/Ministria e Mjedisit lajmëron një kompani private se po ndot ujrat e një lumi përtej niveleve të lejuara nga ligji.

**SKENARI 7:** Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit/Ministria e Mjedisit njofton një kompani private se po ndot ujrat e një lumi, përtej niveleve të lejuara nga ligji.

**SKENARI 8:** Gjatë një seance parlamentare një deputet i opozitës/positës, bën akuza konkrete për implikim në trafik droge, korrupsion, vjedhje, etj. për një deputet të palës tjetër.

**SKENARI 9 :** Deklarata e pasurisë së një gjyqtari në Shqipëri liston pasuri të cilat nuk justifikohen nga paga mujore e tij.

**SKENARI 10:** Supozojmë se një zyrtar i lartë qeveritar merr para të qeverisë për përfitime personale. Gjithashtu le të supozojmë se një nga punonjësit e tij është dëshmitar i këtij veprimi dhe e raporton atë në autoritetin përkatës duke ofruar edhe evidencë të mjaftueshme për ta provuar.

### **Metodologjia e llogaritjes së Indeksit**

Për cdo skenar, të intervistuarit i janë bërë 2 pyetje. Pyetja e parë ishte e ndryshme në varësi të skenarit, ndërsa pyetja e dytë ishte e njëjta për të 10-të skenaret. Në pyetjen e dytë, të intervistuarit kanë zgjedhur midis këtyre opsioneve:

**Te supozojmë se ky informacion (në varësi të skenarit specifik) merret nga media dhe bëhet publik. Cilat nga alternativat e mëposhtme mendoni se është më e mundshme të ndodhë?**

1. Akuza injorohet plotësisht nga autoritetet
2. Hapet një hetim por ai nuk arrin asnjëherë konkluzionet
3. Zyrtari lokal shkarkohet nga detyra dhe dënohet (gjobë ose burg)
9. Nuk e di

Kur i intervistuari ka dhënë përgjigje “Akuza do injorohet plotësisht nga autoritetet”, ka marrë vlerën 0. Në rastet kur respondentit ka dhënë përgjigjen “Hapet një hetim por nuk arrin konkluzione” ka marrë vlerën 0.5. Ndërkohë, në rastet kur i intervistuari ka dhënë përgjigjen “Përgjegjësi procedohet dhe dënohet” ka marrë vlerën 1. Këto vlera janë shumëzuar me 100, në mënyrë që të përfitohet vlera e paraqitur në grafik.


Më specifikisht, Akuzat e ndërsjellta midis palëve në parlament, si dhe përdorimi i automjetit të zyrës për qëllime personale, janë dy nga shkeljet për të cilat të intervistuarit mendojnë se ka më pak gjasa që zyrtarët publik të hetohen, dhe të dënohen. Këto dy skenare, në bazë të indeksit të llogaritur kanë shënuar pikët më të ulëta, me respektivisht 26 dhe 27 pikë (nga 100 të mundshme).

Përsa u përket shkeljeve të bëra nga përfaqësues të rangjeve të ulëta-mesme të administratës (mjek, mësues, etj.), rezultatet tregojnë se të intervistuarit mendojnë se mundësitë që këta përfaqësues të dënohen në rast abuzimi janë përgjithësisht më të larta. Më specifikisht, skenari sipas të cilit një mësues në sektorin publik merr para nga një student për të kaluar klasën, si dhe skenari ku një mjek në institucion shtetëror merr para nga klienti për një shërbim mjekësor, vlerësohen respektivisht me 51 dhe 45 pikë nga 100 të mundshme.

Gjatë grupeve të diskutimit pjesëmarrësve ju parashtruan tre skenare të mundshme, duke i vendosur ata në pozicione hipotetike drejtuese në administratë shtetërore. Skenari i parë kishte të bënte më mundësinë për të ndërhyrë duke garantuar punësimin e një të afërmi në administratë publike, duke shmangur procedurat standarde të punësimit. Skenari i 2-të lidhej me mundësinë për të përdorur automjetin e zyrës shtetërore për çështje personale. Ndërkohë, skenari i 3-të ju paraqiste pjesëmarrësve një rast hipotetik, ku deklarata e pasurisë së një gjyqtari nuk justifikoheshin nga paga e tij mujore. Është interesante të nënvizohet se kur pjesëmarrësit janë pyetur nëse të treja këto skenare përbëjnë shkelje të ligjit dhe duhen ndëshkuar, shumica dërrmuese mendonin që po. Ndërkohë, të vendosur vetë në pozicionin e zyrtarit që i kryen këto veprime pjesëmarrësit japin një vlerësim tjetër.

## Indeksi i Pandëshkueshmërisë

Indeksi mesatar i Pandëshkueshmërisë, në bazë të sondazhit është 38 pikë nga 100 të mundshme, në një shkallë nga 0 deri në 100 ku 0= “Akuza injorohet plotësisht” dhe 100= “Përgjegjësi procedohet dhe dënohet”. Kjo shifër tregon për një mungesë të theksuar besimi, nisur dhe nga përvojat e mëparshme, tek opinioni publik se shkeljet e ligjit, dhe abuzimet e zyrtarëve të lartë dhe të mesëm të sektorit publik ndëshkohen pak ose aspak në vend. Të intervistuarit ndajnë pothuajse të njëjtin perceptim edhe përsa i përket kompanive private të fuqishme, si dhe atyre me lidhje të forta politike në vend.



**Figura 13: Indeksi i Pandëshkueshmërisë**

Grupet e diskutimit gjithashtu tregojnë se shumica e pjesëmarrësve shprehen se nëse do të kishin mundësi të ndërhyjnë për të garantuar punësimin e një të afërmi apo të njohuri në vështirësi financiare, do ta bënin një gjë të tillë. Në të njëjtën kohë, një pjesë e konsiderueshme e tyre binte dakord që ky veprim përbënte një shkelje të qartë ligjore. Disa pjesëmarrës gjithashtu shprehen se si alternativë, do të mundoheshin të ndërhyjnë diku tjetër për të punësuar personin në fjalë, dhe jo në departamentin të cilin drejtonin. Përsa i përket skenarit ku pjesëmarrësit, në rolin e zyrtarit të lartë do të kishin mundësi të përdornin automjetin e punës për çështje personale, shumica thanë se do ta bënin



një gjë të tillë. Kjo konsiderohet nga pjesëmarrësit si një shkelje mjaft e vogël ligjorë, për të cilën jo domodoshmërisht duhet të ndëshkohen. Ndërkohë, mjaft pjesëmarrës nuk e konsiderojnë aspak shkelje një veprim të tillë.

Në rastin e pasurisë së pajustificuar të gjyqtarit, pjesëmarrësit mendojnë se ka shumë pak, ose aspak gjasa që ky i fundit të ndiqet penalisht apo të dënohet. Rastet e fundit publike të ngjashme, kanë përforcuar idenë tek pjesëmarrësit se anëtarët e sistemit gjyqësor të cilët akuzohen për përfshirje në korrupsion në shumicën e rasteve nuk ndiqen penalisht.

Rezultatet e sondazhit, tregojnë gjithashtu qartazi, se ekziston një diferencë tejet domethënëse mbi ato skenare të cilat perceptohen nga shumica e të intervistuarve si shkelje që duhen ndëshkuar ligjërisht, si dhe besimit të intervistuarve që palët e përfshira në këto shkelje, “realisht” do të dënohen. Më specifikisht, ndërsa 95% e të intervistuarve janë të mendimit se zyrtari i cili pranon një rryshet për të favorizuar një kompani në një proces tenderimi, është i korruptuar dhe duhet të ndëshkohet,, vetëm 10% mendojnë se ky zyrtar “realisht” do të ndëshkohet. Ndërkohë, rezultatet tregojnë gjithashtu për një diferencë në perceptim përsa i përket barrës së përgjegjësive së dhënësit dhe marrësit të rryshfetit në skenarët hipotetik. Shumica e të intervistuarve e shohin marrësin e rryshfetit si përgjegjës kryesor, ndërsa palën e dhënësit (kryesisht në rastet e pacientit që jep rryshfet mjekut, apo të studentit që jep lekë pedagogut), si më të justifikuar.




Figure 14: Toleranca ndaj shkeljeve ligjore

### 3.6 Besimi në institucione dhe Vlerësimi i Performancës

Ndërkohë, përsa i përket institucioneve tek të cilat të intervistuarit kanë më pak besim momentalisht, ato janë KQZ-ja, Prokuroria e Përgjithshme dhe Gjyqësori të cilat janë vlerësuar me me respektivisht 29,28 dhe 26 pikë nga 100 të mundshme.





Figura 15: Besimi tek Institucionet

#### 3.6.1 Gjyqësori

*Sistemi Gjyqësor në Shqipëri shihet si përgjithësisht problematik nga të intervistuarit, përsa i përket aftësisë së gjyqtarëve për të zbatuar ligjin dhe për të treguar paanësi në ushtrimin e detyrës. Gjykatat shihen gjithashtu si nën influencën e politikës, dhe të korrupsionit. Korniza ligjore nuk shihet nga publiku si një arsye për paaftësinë e gjykatave për të luajtur një rol të rëndësishëm në luftën ndaj pandëshkueshmërisë në Shqipëri.*


Të intervistuarve u është kërkuar të japin një vlerësim të punës së Gjyqësorit në Shqipëri. Rezultatet tregojnë se 34% e të intervistuarve e vlerësojnë punën e Gjyqësorit “shumë keq” (17%) ose “keq” (17%), ndërsa një numër fare i vogël (2%) i të intervistuarve e kanë

vlerësuar punën e Gjyqësorit si “shumë të mirë”. Ka një numër relativisht të lartë (36%) të të intervistuarve të cilët kanë dhënë një vlerësim neutral (as mirë as keq) për punën e Gjyqësorit. Ky rezultat mund të shpjegohet nga fakti që jo të gjithë të intervistuarit mund të kenë pasur përvoja personale me sistemin Gjyqësor dhe si rrjedhojë kanë dhënë një vlerësim neutral mbi punën e këtij të fundit.



**Figura 16: Vlerësimi i punës së Gjyqësorit**

Perceptimi i qytetarëve mbi paanshmerinë e gjykatësve në Shqipëri është tejet negativ. Të pyetur nëse mendojnë se Gjyqtarët në Shqipëri janë të paanshëm, shumica dërrmuese (84%) e të intervistuarve i janë përgjigjur me “Jo” kësaj pyetjeje. Vetëm 14% e të intervistuarve mendojnë se gjyqtarët në Shqipëri janë të paanshëm.



**Figura 17: Paanshmëria e Gjyqësorit**


Pjesëmarrësit në grupet e diskutimit vërtetuan mungesën e theksuar të besimit të qytetarëve tek sistemi Gjyqësor në Shqipëri. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në diskutimet e tyre vunë theksin tek dështimi i sistemit gjyqësor për të dhënë vendime të drejta, sidomos për zyrtarët e lartë publik dhe individë të tjerë me influenca politike apo ekonomike. Zvarritjet e pajustificuara të proceseve Gjyqësore, përhapja e fenomenit të korrupsionit në sistem, si dhe mungesa e kontrollit mbi punën e gjykatësve, kanë bërë që shumica e pjesëmarrësve ta konsiderojnë drejtësinë në Shqipëri si diçka që mund ta kesh vetëm nëse paguan shumën e duhur.

*„Kur je në gjyq të kërkojnë para, pa para nuk bëhet asgjë, zgjatet shumë periudha e gjykimit.“ (Shkodër, Urban)*

*“Kush bën një shkelje, një vrasje, nuk po them për njerëzit fukarenj se ata nuk dalin jo, por njerëzit që sheh mbas një jave, muaji apo viti duke shëtitur të lirë. Pse? Se kanë paguar lek për të dalë jashtë.“ (Shkodër, Rural)*

Shumica dërmuese (86%) e të intervistuarve mendojnë se Gjykatat në Shqipëri janë gjatë gjithë kohës në ndikimin e pushteve ekonomike dhe politike në Shqipëri, duke dhënë kështu vendime jo të drejta dhe si rrjedhojë duke cënuar vazhdimisht besimin e publikut tek to. Një numër po kaq i madh të intervistuarish (85%) mendojnë gjithashtu se

arsyeja kryesore pse Gjykatat në Shqipëri nuk japin drejtësi lidhet me përhapjen në masë të fenomenit të korrupsionit në këtë sektor. Mungesa e profesionalizmit, apo mangësitë ligjore rrallë shihen si shkak i paaftësisë të sistemit Gjyqësor për të dhënë vendime të drejta në Shqipëri.




**Figura 18: Vlerësime për Gjyqësorin/Gjykatësit në Shqipëri**

Përsa i përket kornizës ligjore në Shqipëri, shumica e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit mendojnë se ajo është e plote dhe e hartuar mirë. Problemi, sipas pjesëmarrësve qëndron tek mos zbatimi korrekt i ligjit nga Gjyqtarët në Shqipëri, kryesisht si pasojë e korrupsionit në sistem. Kjo mungesë profesionalizmi, sipas pjesëmarrësve ka sjellë si rrjedhojë mungesën e dënimeve të zyrtarëve publik apo individë të tjerë me influencë politike ose ekonomike. Për më tepër, një përvojë e tillë ka përforcuar idenë e pjesëmarrësve se pavarësisht deklaratave të institucioneve ligjzbatuese, jo të gjithë janë të barabartë përpara ligjit në Shqipëri.

*“[Mendoni që janë të paanshëm gjyqtarët?] Janë. Nëse bëhet fjalë për dy njerëz të thjeshtë janë të paanshëm. Nëse bëhet fjalë për një njeri me pozitë dhe një tjetër të thjeshtë, nuk janë.” (Shkodër, Rural)*

Ryshfeti, lidhjet e biznesit te gjykatesve, si dhe politika, shihen nga të intervistuarit si faktorët kryesorë që ndikojnë në marrjen e vendimeve në Shqipëri. Kështu, 84% e të intervistuarve mendojnë se “Ryshfeti” është një faktor që “influencën shumë” vendimet e gjyqtarëve, ndjekur nga 72% të cilët mendojnë të njëjtën gjë për “lidhjet e biznesit” të vetë gjykatësve. Ajo që duhet theksuar nga rezultatet, është fakti se vetëm 2 në 5 të intervistuar mendojnë se faktet dhe ligje e aplikueshme në cdo rast “influencojnë shumë” në marrjen e vendimeve nga gjykatësit në Shqipëri.




**Figura 19: Faktorët që ndikojnë në dhënien e vendimeve gjyqësore**

### 3.6.2. Policia e Shtetit

**Policia e Shtetit vlerësohet përgjithësisht me nota pozitive nga qytetarët. Qytetarët vënë re një ndryshim pozitiv në performancën e Policisë së Shtetit në terren, si dhe vlerësojnë pozitivisht disa nga iniciativat e ndërmarra nga kjo e fundit.**

Rreth 7 në 10 të intervistuar e vlerësojnë punën e Policisë së Shtetit aktualisht si “Shumë të mire” (17%), ose “të mirë” (53%). Shumë pak të intervistuar mendojnë se performanca e Policisë së Shtetit është negative. Pjesëmarrësit në grupet e diskutimit shprehen se përgjithësisht vënë re një ndryshim pozitiv në punën e Policisë së Shtetit në terren, të nxitur edhe nga aksionet e shumta të raportuara në media në kohët e fundit. Qytetarët vlerësojnë kryesisht shtimin e numrit të oficerëve të Policisë në terren, punën e Policisë së Shtetit në disiplinimin e qarkullimit rrugor në vend, si dhe gatishmërinë. Megjithatë,

disa pjesëmarrës shprehin shqetësimin e tyre për disa prej aksioneve të fundit të Policisë së Shtetit, përfshirë operacionin për ndalimin e vjedhësve të energjisë, si dhe të vendosjes së gjobave për shkelësit e rregullave të qarkullimit rrugor.



**Figura 20: Vlerësimi i punës së Policisë së Shtetit**


*“Në përgjithësi shoh që policia ka një përgjegjshmëri më të madhe dhe një zbatueshmeri më të mirë të detyrave që asaj i takon.” (Tiranë, Urban)*

*“Njerëzit janë më të afrueshëm me policinë tani dhe mund të shprehin me lirshëm. Më përpara kisha frike të bëje një denoncim për dikë kurse tani besimi është në shkallë maksimale.” (Tiranë, Urban)*

*“Policinë e shtetit e ke në çdo vend në patrullë. E ke në shesh, në rrugë, kudo. Policinë sot e ke kundër krimit të hapur që rrallë herë e kanë bërë .Dhe nuk të vë përpara kushtin se e kujt je, nuk të pyet fare.” (Tiranë, Urban)*

Megjithatë, qytetarët ende besojnë se ka diferencime përsa i përket zbatimit të ligjit nga policia, si dhe mendojnë që Policia e Shtetit është nën presion politik dhe ekonomik. Në të njëjtën kohë, qytetarët vënë re mangësi në trajnimin dhe profesionalizmin e treguar nga Policia e Shtetit në punën e saj të përditshme.

Të pyetur nëse ligji zbatohet njësoj për të gjithë nga Policia e Shtetit 68% e të intervistuarve kanë thënë “Jo”, ndërsa vetëm 29% kanë thënë “Po”. Grupet e diskutimit nxorrën gjithashtu në pah se shumica e pjesëmarrësve nuk mendojnë se ligji zbatohet njësoj për të gjithë nga Policia e Shtetit. Shumë prej tyre mendojnë se Policia Rrugore, shpesh nuk silllet njësoj me qytetarët e thjeshtë, dhe me ata që kanë një njohje me influencë.



**Figura 21: Zbatimi i ligjit nga Policia e Shtetit**

Shumica e të intervistuarve (87%) mendojnë se Policia e Shtetit është nën presionin e pushtetit politik dhe ekonomik duke ndikuar kështu në performancën e saj në terren. Shumica e të intervistuarve gjithashtu, vënë re mangësi në trajnimin e oficerëve të



Policisë së Shtetit, fakt i cili ndikon në mungesën e profesionalizmit në punën e saj të përditshme si dhe mos zbatimin e ligjit në mënyrën e duhur. Pothuajse gjysma (48%) e të intervistuarve, mendojnë se Policia e Shtetit është në masën më të madhe e korruptuar, gjë që e pengon atë ta zbatoj ligjin njësoj për të gjithë qytetarët.





Figura 22: Vlerësime për Policinë e Shtetit

### 3.6.3 Prokuroria e Përgjithshme

*Qytetarët Shqiptarë janë të ndarë përsa i përket vlerësimit të tyre mbi punën e Prokurorisë së Përgjithshme deri më sot. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve shprehen se nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi punën e Prokurorisë së Përgjithshme, duke e bërë të pamundur dhënien e një vlerësimi objektiv për të. Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm i qytetarëve për Prokurorinë e Përgjithshme është se kjo është një institucion përgjithësisht i korruptuar, dhe që nuk e ushtron detyrën e vet me profesionalizëm.*

Pothuajse 1 në 3 të intervistuar ka dhënë një vlerësim neutral për punën e Prokurorisë së Përgjithshme deri më sot, ndërsa pothuajse i njëjti numër të intervistuarish e ka vlerësuar punën e kësaj të fundit si “shumë të mirë” ose të mirë. Ndërkohë, rreth 1 në 4 të intervistuar e kanë vlerësuar punën e këtij institucioni si “të keqe” ose “shumë të keqe”. Ajo çfarë është interesante, është se vlerësimi i performancës së Prokurorisë nga të intervistuarit është pothuajse i njëjtë me atë mbi gjykatat dhe sistemin gjyqësor në bazë të rezultateve. Kjo mund të shpjegohet nga fakti se shumica e qytetarëve e shohin punën e prokurorisë dhe prokurorëve ngushtësisht të lidhur me atë të gjykatave në vend.




**Figura 23: Vlerësimi i punës së Prokurorisë së Përgjithshme**

Gjatë grupeve të diskutimit, një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve e ka patur po kaq të vështirë të japin një vlerësim për punën e Prokurorisë së Përgjithshme. Kjo, sipas tyre, vjen kryesisht për faktin se procedurat hetimore të këtij institucioni zhvillohen përgjithësisht larg syve të opinionit publik .

Të pyetur mbi këtë temë, ekspertët ligjor vërejnë se mungesa e vullnetit për fuqizimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjeve, si në burime njerëzore ashtu dhe në ato financiare, si në rastin e Prokurorisë së Përgjithshme, përbën një pengesë të madhe në përpjekjet për luftimin e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend. Mungesa e kapaciteteve si financiare, ashtu edhe njerëzore të këtyre institucioneve, sipas ekspertëve, ndikon negativisht në punën e tyre në luftën ndaj fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend.

I njëjti problem, sipas tyre, vërehet edhe tek entet e pavarura të cilat si detyrë kryesore kanë kontrollin e veprimtarisë së institucioneve ligjzbatuese. Një fuqizim i tillë i institucioneve ligjzbatuese, shihet si një domosdoshmëri nga ekspertët, si vendas, ashtu dhe të organizatave ndërkombëtare në Shqipëri. Ekspertë juridik të intervistuar, shprehen se shpesh herë, ndodh që ngrihen struktura dhe ente të pavarura në vend, kryesisht sipas modeleve të vendeve të tjera, por duke mos ju referuar rrethanave dhe burimeve të nevojshme për mirëfunksionimin e tyre.

Të pyetur nëse Prokuroria e Përgjithshme apo prokurorët e zbatojnë ligjin njësoj për të gjithë qytetarët, shumica e të intervistuarve (86%) kanë thënë “Jo”. Rezultatet përforcohen nga gjetjet e grupeve të diskutimit, ku pjesëmarrësit shprehen se ligji nuk zbatohet njësoj nga prokurorët në Shqipëri, për shkak të influencave politike, si dhe përhapjes së korrupsionit tek prokurorët. Në mënyrë të veçantë, për zyrtarët e lartë publik, pjesëmarrësit në diskutime mendojnë se Prokuroria e Përgjithshme, dhe prokurorët në përgjithësi rrallë herë i çojnë hetimet deri në fund, ose shpesh i zvarrisin këto dosje deri sa ato të bëhen të pavlefshme për shkak të procedurave.



**Figura 24: Zbatim i ligjit nga Prokuroria e Përgjithshme/Prokurorët**

Shumica e të intervistuarve (85%), gjithashtu mendojnë se prokurorët në Shqipëri janë nën ndikimin e pushtetit politik dhe ekonomik gjatë punës së tyre (Fig.25). Si rrjedhojë, sipas të intervistuarve, prokurorët në Shqipëri janë të korruptuar dhe nuk e bëjnë siç duhet punën e tyre. Pothuajse gjysma e të intervistuarve (43%) gjithashtu mendon se prokurorët në Shqipëri nuk kanë kualifikimin e duhur duke cënuar kështu profesionalizmin në institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme.

Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i pjesëmarrësve në grupet e diskutimit shprehen se përderisa emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm është politik, atëherë edhe puna e këtij institucioni do të jetë nën influencën e kësaj të fundit. Gjithashtu, pjesëmarrësit i shohin prokurorët në Shqipëri si përgjithësisht të korruptuar, dhe me mungesë të theksuar të profesionalizmit.


## Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme?

N=1000

■ Jam shumë dakord ■ Jam dakord ■ Nuk jam dakord ■ Nuk jam aspak dakord ■ Nuk e di

### Prokurorët në Shqipëri....


Janë nën ndikimin e pushtetit politik dhe ekonomik gjatë punës së tyre duke çenuar kështu besimin e publikut



Nuk e bëjnë punën në mënyrën e duhur sepse shumica e prokurorëve janë të korruptuar




Nuk kanë kualifikimin e duhur duke çenuar kështu profesionalizmin e institucionit



Jane shumë të kualifikuar dhe ushtrojnë profesionin e tyre me profesionalizëm



Janë të paanshëm, proaktive, dhe efektiv në punën e tyre, duke rritur kështu besimin në publik



Janë te pavarur dhe nuk u nënshtrohen influencave politike dhe ekonomike gjatë zbatimit të ligjit



Figura 25: Vlerësime për Prokurorinë e Përgjithshme/Prokurorët në Shqipëri

*“Prokuroria për mendimin tim bën aq sa i lejohet të bëj. Ka disa raste ku ajo nuk është e lirshme të punoj siç duhet, qoftë nga një ndikim i jashtëm apo qoftë dhe një ndikim i brendshëm.” (Tiranë, Urban)*

*“Prokurorët në Shqipëri janë politik, marrin urdhëra nga politika përderisa janë të caktuar nga politika. Mban anë politike, ps.h nese janë hetime të mëdha , çështje ministrash nëse është ministër i krahut të tij ai nuk e shtyn çështjen më tutje.” (Fier, Komunë)*

*“Prokuroria është më e korruptuara, ka prokurorë që nuk e njohin ligjin fare, ka prokurorë që kërkojnë dënimin sipas lekut që ju jep.” (Fier, Rural)*

## 4. Gjetjet Kryesore- Kampioni i të Rinjve

### 4.1 Informacion i Përgjithshëm

Një nga objektivat kryesorë të këtij studimi mbi fenomenin e pandëshkueshmërisë, përveç identifikimit të perceptimeve aktuale mbi shkaqet e përhapjes së fenomenit në vend, ishte edhe vlerësimi i tendencave të tij në të ardhmen. Për të bërë të mundur një vlerësim të tillë, ky studim i ka kushtuar një hapësirë të veçantë grupmoshave të reja, kryesisht midis 18-24 vjeç. Më specifikisht, gjatë hulumtimit cilësor, janë organizuar grupe të veçanta për këtë grupmoshë, ndërsa kampioni i popullatës së përgjithshme është përforcuar me një kampion shtesë prej 200 të rinjve nga mosha 18- 24 vjeç. Ky seksion, është një pasqyrim i detajuar i rezultateve dhe informacionit marrë nga të rinjtë mbi fenomenin e pandëshkueshmërisë në vend.

*Për të rinjtë, ashtu si dhe për pjesën tjetër të popullsisë, korrupsioni, mungesa e ligjeve dhe cilësisë së tyre, si dhe mangësitë e sistemit të drejtësisë shihen si faktorët kryesorë që ndikojnë në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në Shqipëri.*





Figura 26: Faktorët që ndikojnë në përhapjen e Pandëshkueshmërisë (Të rinj)

Të rinjtë në Shqipëri mendojnë se *Korrupsioni (77%), moszbatimi i ligjeve (72%), si dhe mangësitë/mosfunksionimi i sistemit gjyqësor (68%) janë faktorë shumë të rëndësishëm përse i përket ndikimit të tyre në përhapjen e fenomenit të pandëshkueshmërisë në vend.*

Të dhënat e sondazhit konfirmohen edhe nga grupet e diskutimit me grupmoshat e reja, ku Grupet e pjesëmarrësit shohin mangësitë e sistemit të drejtësisë, dhe pushtetin politik si faktorët që ndikojnë më shumë në përhapjen e fenomenit në Shqipëri. Pjesëmarrësit në këto grupe shprehen gjithashtu se lidhjet politike dhe ekonomike bëhen shpesh pengesë për zbatimin e ligjit nga institucione të ndryshme në vend. Korrupsioni dhe mungesa e profesionalizmit në sistemin gjyqësor konsiderohet gjithashtu si një faktor me mjaft ndikim në përhapjen e kulturës së pandëshkueshmërisë.

***Perceptimi i Pandëshkueshmërisë tek të rinjtë në Shqipëri ndryshon pak ose aspak në krahasim me pjesën tjetër të popullatës. Ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, të rinjtë në Shqipëri mendojnë se ka më shumë mundësi për tu ndëshkuar kur shkelen rregullat e qarkullimit rrugor, apo kur falsifikohen dokumentat.***

Në një shkallë nga 0 deri në 100, ku 0 = aspak mundësi, dhe 100 = shumë mundësi për secilin nga skenaret e paraqitur, ka pak ndryshim midis perceptimit mbi pandëshkueshmërinë të rinjve krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Të rinjtë, ashtu si pjesa tjetër e popullatës, mendojnë se ka më shumë mundësi të ndëshkohen nëse falsifikojnë dokumentat (74 pikë nga 100), u shmangen taksave (70 nga 100) si dhe nëse shkelin rregullat e qarkullimit rrugor me 67 pikë nga 100 të mundshme. Ndërkohë, të rinjtë në Shqipëri mendojnë se mundësia për tu ndëshkuar nëse paguajnë dikë në dorë për të marrë një shërbim të caktuar si dhe nëse ndërhyjnë për të punësuar një të afërm të tyre është mjaft e vogël, duke shënuar respektivisht 47 dhe 48 pikë nga 100 të mundshme. Grupet e diskutimit gjithashtu nxorën në pah faktin se të rinjtë, ashtu si pjesa tjetër e popullatës në Shqipëri i shohin pagesat në dorë për të marrë shërbime në institucione publike si të zakonshme, dhe raste në të cilat ka pak gjasa që të ndëshkohesh. Ndërsa përse i përket shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, të rinjtë shprehen se së fundmi, mundësitë për tu ndëshkuar nga policia për këto shkelje janë rritur ndjeshëm.



**Figura 27: Perceptimi i Pandëshkueshmërisë (Të Rinj/Të Rritur)**

Ndërkohë, perceptimi i të rinjve për nivelin e ndëshkueshmërisë së zyrtarëve të lartë në rast shkeljes është i ulët, duke shënuar , 29 pikë nga 100 të mundshme në indeks (Fig. 28). Ashtu si pjesa tjetër e popullatës, të rinjtë mendojnë se mundësitë më të pakta që një zyrtar i lartë të dënohet, janë kur ai paguan nën dorë në një institucion publik (22 pikë nga 100 të mundshme), si dhe kur ndërhyjnë për të punësuar një të afërm (21 pikë nga 100 të mundshme). Ndërkohë, falsifikimi i dokumentave, dhe evazoni fiskal shihen si rastet kur mundësitë që një zyrtar i lartë të dënohet janë relativisht më të larta, me 36 pikë nga 100 të mundshme në të dyja rastet. Megjithatë, vlerësimi tregon se sipas perceptimit të të rinjve në Shqipëri, ka shumë pak mundësi reale (50 pikë në shkallë) që për secilin nga këta dy skenare një zyrtar i lartë të dënohet në Shqipëri.







Figure 28: Perceptimi i Pandëshkueshmërisë për zyrtarët e lartë (Të Rinj/Të Rritur)

## 4.2 Vlerësimi i Performancës së Institucioneve ( Të Rinj )

### 4.2.1 Gjyqësori

*Të rinjtë në Shqipëri kanë një perceptim dukshëm më pozitiv përsa i përket performancës së Gjyqësorit, krahasuar me pjesën tjetër të popullatës. Megjithatë, perceptimi i përgjithshëm i shumicës së të rinjve për sistemin gjyqësor, është se ai ndodhet nën influencën e vashdueshëm të politikës. Një numër i konsiderueshëm i të rinjve mendon gjithashtu se sistemi është i prekur në masë të madhe nga fenomeni i korrupsionit.*

Pothuajse 2 në 5 të rinj të intervistuar e vlerësojnë punën e sistemit Gjyqësor në Shqipëri si “shumë të mirë” ose të “mirë”, krahasuar me 1 në 5 të intervistuar nga popullata e përgjithshme që ndan të njëjtin mendim.



**Figura 29: Vlerësimi i Punës së Gjyqësorit (Të rinj/ Të rritur)**

Megjithatë, pavarësisht një vlerësimi në dukje më pozitiv të punës së gjyqësorit, rezultatet e sondazhit tregojnë se, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, shumica (61%) e të rinjve të intervistuar, mendojnë se gjykatat në Shqipëri janë nën presionin politik dhe ekonomik, duke çenuar kështu besimin e qytetarëve tek këto institucione. Për më tepër, 1 në 2 të intervistuar, mendon se një nga mangësitë kryesore të sistemit gjyqësor në vend është edhe mungesa e kualifikimit të duhur tek Gjykatësit, duke sjellë si rrjedhojë dhënien e vendimeve të gabuara. Vetëm 1 në 5 të intervistuar nga grumoshat e reja, mendon se gjykatat në Shqipëri janë të paanshme, dhe bazohen në fakte për të dhënë vendimet e tyre. Kjo tregon për një mungesë të theksuar të besimit tek të rinjtë në sistemin gjyqësor në vend.

## Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme

Të rinj (18-24 vjeç)

N=328





Figura 30: Vlerësime për Gjyqësorin/Gjykatësit në Shqipëri? (Të rinj)

Të pyetur se cilët faktorë ndikojnë më shumë në dhënien e vendimeve gjyqësore në Shqipëri, të rinjtë kanë dhënë përgjigje relativisht të ngjashme me pjesën tjetër të popullsisë. Kështu, rreth 4 në 5 të rinj të intervistuar (Fig.29) mendojnë se Paraja/Ryshfeti influencën shumë në këtë aspekt. Po kaq me influencë në veprimtarinë e gjyqtarëve në vend shihen Politika (75%) dhe lidhjet personale të Gjykatësit me 70%. Ashtu si dhe pjesa tjetër e të intervistuarve, vetëm 2 në 5 të intervistuar mendojnë se faktet dhe ligjet kanë influencë të madhe në vendimet e dhëna nga gjykatësit në Shqipëri. Ndërkohë, grupet e diskutimit po ashtu nxorrën në pah mungesën e theksuar të besimit të të rinjve tek sistemi gjyqësor në vend, sidomos përsa u përket rasteve kur janë të përfshirë zyrtarët e lartë. Megjithatë shumica e pjesëmarrësve nuk kishin patur përvoja personale me gjykatat, si burim informacioni për ta shërbenin diskutimet me miqtë, vendimet e dhëna nga gjykatat, si dhe raportimet mediatike mbi procese të bujshme të kohëve të fundit në vend.

*“Ky i yni nuk është sistem gjyqësor i mirëfilltë por është sistem, sekser...Në letër mund të jetë shumë gjëra por realisht kështu është.” (Tiranë, Urban)*

*“Gjyqtarët në Shqipëri janë të punësuar me vendime politike, ka anshmëri në shumicën e gjyqeve, korrupsion midis gjykatësve dhe avokatëve.” (Shkodër, Rural)*




**Figura 31: Faktorët që ndikojnë në dhënien e vendimeve Gjyqësore (Të rinj)**

#### 4.2.2 Policia e Shtetit

*Shumica e të rinjve në Shqipëri e vlerëson pozitivisht performancën e Policisë së Shtetit. Megjithatë, të rinjtë, ashtu si popullata e përgjithshme, mendojnë se Policia e Shtetit ndodhet nën presion të vazhdueshëm politik, i cili shpesh ndikon në profesionalizmin e Policisë së Shtetit dhe në uljen e besimit të publikut tek ky institucion.*

Ka pak, ose aspak ndryshime përsa i përket vlerësimit të punës së Policisë së Shtetit nga të rinjtë (Fig.32), krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Kështu, më shumë se 4 në 5 të rinj të intervistuar e vlerëson punën e Policisë së Shtetit si të “mirë”, ose “shumë të mirë” dhe po aq të intervistuar nga pjesa tjetër e popullsisë ndajnë të njëjtin mendim. Të rinj në grupet e diskutimit gjithashtu konfirmojnë gjetjet e sondazhit. Shumë prej tyre shprehen se performanca e efektivëve të Policisë së Shtetit ka pësuar një përmirësim të dukshëm gjatë vitit të fundit. Pjesëmarrësit në këto grupe vlerësojnë shtimin e numrit të patrullave nëpër rrugë, një gatishmëri më të madhe të Policisë për të ndërhyrë në rastet kur kërkohet ndihma e tyre nga qytetarët, si dhe një menaxhim më të mirë të trafikut.



**Figura 32: Vlerësimi i punës së Policisë së Shtetit (Të rinj)**

Megjithatë, pothuajse 3 në 5 të intervistuar nga grupmoshat e reja (18-24 vjeç) mendojnë se Policia e Shtetit gjendet në një presion të vazhdueshëm politik (Fig.33), duke çënuar kështu performancën e saj, dhe rrjedhimisht besimin e publikut tek ky institucion. Ndërkohë punonjësit e policisë së shtetit konsiderohen nga një numër të madh të rinjsh si pa trajnimin e nevojshëm, dhe jo në dijeni të plotë të legjislacionit. Paanshmëria e institucionit të Policisë së Shtetit përsa i përket zbatimit të ligjit në terren, vihet gjithashtu në dyshim nga një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve (60%). Për më tepër, shumica e pjesëmarrësve në grupet e diskutimit, mendojnë se shumë prej problemeve të së shkuarës, kryesisht përsa i përket influencës së politikës mbi Policinë, mungesën e profesionalizmit, si dhe korrupsionit ende vazhdojnë të përbëjnë pengesa në marrëdhënien e tyre me këtë institucion.

## A jeni dakord me pohimet e mëposhtme?

N=1200

■ Jam shumë dakord ■ Jam dakord ■ Nuk jam dakord ■ Nuk jam aspak dakord ■ Nuk e di

### Policia e Shtetit/Punonjësit e Policisë....





Figura 33: Vlerësime për Policinë e Shtetit ( Të rinj)

### 4.2.3 Prokuroria e Përgjithshme

*Të rinjtë Shqiptarë kanë një perceptim deri diku më pozitiv për punën e Prokurorisë së Përgjithshme, krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë. Megjithatë, shumë prej të rinjve ende shprehen skeptik mbi pavarësinë e këtij institucioni nga influencat politike dhe ekonomike. Mungesa e profesionalizmit të prokurorëve në vend, ashtu si për pjesën tjetër të popullatës, shihet nga të rinjtë si një pengesë për funksionimin e kësaj hallke të sistemit të drjetësisë në vend.*

Pothuajse gjysma e të rinjve (18-24 vjeç) të intervistuar mendojnë se Prokuroria e Përgjithshme në Shqipëri ka bërë punë “të mirë” (42%), ose “shumë të mirë” (2%) deri më sot, krahasuar me vetëm 1 në 3 të intervistuar nga pjesa tjetër e popullatës që ndan të njëjtin mendim.



**Figura 34: Vlerësimi i punës së Prokurorisë së Përgjithshme (Të rinj)**


Përsa i përket perceptimit që të rinjtë kanë për prokurorët në Shqipëri, ashtu si dhe pjesa tjetër e popullsisë, rezultatet tregojnë për një skepticizëm të ndjeshëm në raport me pavarësinë dhe profesionalizmin e tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Rreth 4 në 5 të rinj të intervistuar “nuk janë aspak dakord” ose “nuk janë dakord” me pohimin sipas të cilit prokurorët në Shqipëri janë të pavarur nga influencat politike gjatë zbatimit të ligjit (Fig.35). Ndërkohë, pothuajse po kaq të rinj, mendojnë se prokurorët në Shqipëri nuk e bëjnë mirë punën e tyre për shkak se shumica janë të korruptuar.

Grupet e diskutimit po ashtu nxorren në pah mungesën e besimit tek të rinjtë, ashtu si dhe tek pjesa tjetër e popullatës, mbi punën e institucionit të Prokurorisë, si dhe të prokurorëve në përgjithësi. Korrupsioni, influencat politike, si dhe mungesa e profesionalizmit shihen si mangësitë kryesore të punës së prokurorëve në vend. Megjithatë duhet nënvizuar fakti se informacioni që pjesëmarrësit kanë mbi punën e këtij institucioni, apo edhe të prokurorëve në vend është shpesh herë shumë i kufizuar. Kjo, sipas pjesëmarrësve, vjen si rrjedhojë e vetë natyrës së punës së prokurorëve. Për

këtë arsye, shumë prej pjesëmarrësve e kishin shpesh të pamundur për të dhënë një vlerësim të punës së Prokurorisë së Përgjithshme, apo të prokurorëve në përgjithësi.

*“Prokuroria është e politizuar, e influencuar shumë në vendimarrje që nënkupton jo vetëm nga politika por dhe nga njohtet. Shpesh është e padrejtë.” (Tiranë, Urban)*

*“Nuk punohet në prokurori. Kanë volum pasi e di se kam njohte dhe ja kam idenë, por nuk punohet. Ngrihen grupe, struktura që bëjnë kontrollet e prokurorive të rrethit dhe me radhë por rezultatet janë shumë selektive. (Tiranë, Urban)*




**Figure 35: Vlerësime Vlerësime për Prokurorinë e Përgjithshme/Prokurorët në Shqipëri (Të rinj)**

Të pyetur se cili institucion po bën punën më të mirë në luftën kundër pandëshkueshmërisë, Media është zgjedhur nga 28% të rinjve të intervistuar si aktori kryesor në këtë drejtim (Fig. 36), në mënyrë të ngjashme me pjesën tjetër të popullsisë. Si aktorë të dytë më të rëndësishëm, të rinjtë, ashtu si pjesa tjetër e popullsisë, shohin Qeverinë, dhe Policinë,



me respektivisht 15% dhe 13% të të intervistuarve. Gjetjet e sondazhit konfirmohen nga pjesëmarrësit e grupeve të diskutimit të cilët shprehen se momentalisht Policia e Shtetit dhe Qeveria janë institucionet të cilat janë duke bërë punën më të mirë për të luftuar fenomenin. Një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish gjithashtu shprehin mbështetjen e tyre për disa nga reformat e qeverisë, duke theksuar se besojnë që këto reforma do të kenë një efekt të rëndësishëm për rritjen e nivelit të ndëshkueshmërisë së zyrtarëve të lartë në veçanti, si dhe të sundimit të ligjit në përgjithësi.



**Figura 36: Performanca e institucioneve në luftën ndaj Pandëshkueshmërisë**

